

KODI I RRJETIT - KODI OPERATIV

Shkurt 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje.....	7
2	Kodi i testimit dhe monitorimit	8
2.1	Parathënie.....	8
2.2	Objektivi.....	8
2.3	Fushëveprimi	8
2.4	Monitorimi.....	9
2.5	Testimi	9
3	Kodi i ndërlidhjes operative dhe furnizimit me informata të ndodhive.....	11
3.1	Parathënie.....	11
3.2	Objektivi.....	11
3.3	Fushëveprimi	11
3.4	Operimet dhe ndodhitë (ngjarjet).....	12
3.4.1	Kërkesat e përgjithshme.....	12
3.4.2	Mjetet e komunikimit	13
3.4.3	Operimet.....	13
3.4.4	Forma dhe koha e një njoftimi të operimit.....	14
3.4.5	Ndodhitë.....	14
3.4.6	Forma dhe koha e një njoftimi të ndodhisë.....	15
3.5	Paralajmërimet e sistemit	15
3.5.1	Paralajmërimet e përgjithshme.....	15
3.5.2	Situatat e alarmit.....	16
3.5.3	Situatat emergjente.....	16
3.5.4	Situata tjera serioze.....	17
3.5.5	Raportimi i incidenteve të mëdha.....	17
3.5.6	Shqyrtimet e përbashkëta.....	18
3.6	Raportet në formë të shkruar	18
3.6.1	Përmbajtja e raportit në formë të shkruar	19
4	Kodi i koordinimit të sigurisë	21
4.1	Parathënie.....	21
4.2	Objektivi.....	21
4.3	Fushëveprimi	21
4.4	Aranzhimet e përgjithshme	22
4.4.1	Përgjegjësitë e menaxhimit të sigurisë.....	22
4.4.2	Sistemi i miratuar i menaxhimit të sigurisë.....	22

4.4.3	Procedura për përshtatjen e rregullave të sigurisë.....	22
4.4.4	Kufijtë e punës.....	23
4.4.5	Koordinatorët e sigurisë.....	23
4.5	Procedurat	23
4.5.1	procedurat e përgjithshme	23
4.5.2	Njoftimi	24
4.5.3	Implementimi i koordinimit të sigurisë	24
4.5.4	Punimet në të dy anët e pikës së kyçjes	25
4.5.5	Marrëveshja e ndarjes	25
4.5.6	Implementimi i ndarjes.....	25
4.5.7	Marrëveshja e tokëzimit	26
4.5.8	Implementimi i tokëzimit.....	26
4.5.9	Raportimi i sigurisë	26
4.5.10	Autorizimi.....	27
4.5.11	Testimet	27
4.5.12	Procedura e rikthimit në gjendjen e mëparshme.....	28
4.6	Kërkesat e ndërlidhura	28
4.6.1	Humbja e integritetit (besueshmërisë) të masave parandaluese.....	28
4.6.2	Siguria mjedisore	29
4.6.3	Inspektimet.....	29
4.6.4	Kontrolli i sistemit	29
4.6.5	Përgatitja e dokumentacionit.....	29
4.6.6	Diagramet (skemat) e sistemit	30
4.6.7	Komunikimet.....	30
5	Kodi i planifikimit të rasteve të paparashikuara	30
5.1	Parathënie.....	30
5.2	Objektivi	31
5.3	Fushëveprimi	31
5.4	Mekanizmat mbrojtës.....	32
5.5	Organizimi i sistemit të mbrojtjes rele.....	32
5.5.1	Sistemet e mbrojtjes rele	33
5.5.2	Stabiliteti dhe mbingarkesa e rrjetit.....	33
5.5.3	Mbrojtja nga frekuenca e lartë /e ulët.....	34

Tabela 1 – Veprimet për frekuencën e ulët të sistemit..... 35

Tabela 2 – Veprimet për frekuencën e lartë të sistemit 35

5.5.4	Reduktimi nga nënfrekuenca.....	36
5.5.5	Mbrojtja nga mbitensioni.....	36
5.5.6	Mbrojtja nga nëntensioni.....	36
5.5.7	Komunikimet dhe kontrolli.....	37
5.6	Parashtrimi i kërkesave të mbrojtjes	37
5.6.1	Kërkesat kryesore.....	37
5.6.2	Eliminimi i prishjeve.....	37
5.6.3	Analiza e prishjeve	37
5.6.4	Diskriminimi.....	38
5.6.5	Mbrojtja rezervë	38
5.6.6	Teknologjia e re.....	38
5.6.7	Mbrojtja e linjës së transmisionit	39
5.6.8	Mbrojtja e autotransformatorëve 400 kV dhe 220 kV	39
5.6.9	Mbrojtja e zbarës.....	39
5.6.10	Mbrojtja nga defektet e ndërprerësit të qarkut	39
5.6.11	Aranzimet (tarimet) e mbrojtjes	40
5.6.12	Mirëmbajtja e mbrojtjes rele.....	41
5.7	Masat manuale emergjente.....	41
5.8	Startimi nga errësira	41
5.8.1	Rënia totale.....	41
5.8.2	Rënia e pjesëshme	42
5.8.3	Rëniet totale ose të pjesshme	42
5.8.4	Njoftimi	42
5.8.5	Procedura e rikthimit në punë.....	42
5.8.6	Proceset kyçe.....	43
5.8.7	Hapat kyç.....	43
5.8.8	Plani i rikthimit të sistemit energjetik.....	43
5.8.9	Konkluzionet e rikthimit të sistemit energjetik	44
5.8.10	Raportimi pas rënies totale ose të pjesshme	44
5.8.11	Testimi i startimit nga errësira.....	44
5.8.12	Komunikimet e startimit nga errësira dhe kontrolli	44
5.8.13	Trajnimi i personelit dhe familjarizimi.....	45
5.8.14	Konfidencialiteti.....	45
5.9	Humbja e qendrës së kontrollit.....	45
5.9.1	Plani i krizës së qendrës së kontrollit	45
5.9.2	Testimi i planit të krizës së qendrës së kontrollit	46
5.10	Procedurat e incidenteve të përbashkëta të sistemit.....	46

5.10.1	Numrat e kontaktit.....	46
5.10.2	Paraqitja e një ndodhie	46
5.11	Veprimet që pasojnë njoftimit të ndodhive	47
6	Kodi i rregullimit të ngarkesës.....	48
6.1	Parathënie.....	48
6.2	Objektivi.....	49
6.3	Fushëveprimi	49
6.4	Menaxhimi i ngarkesës dhe ngarkesat me mundësi të shkyçjes.....	49
6.4.1	Kushtet për marrëveshje të shërbimeve ndihmëse.....	50
6.4.2	Marrëveshje vullnetare me një përdorues të ngarkesës	50
6.4.3	Marrëveshja vullnetare me një furnizues	50
6.4.4	Njoftimet paralajmëruese.....	51
6.5	Aranzhimet e reduktimit manual emergjent të ngarkesës.....	51
6.5.1	Rastet e reduktimit manual emergjent	51
6.5.2	Aranzhimet.....	52
6.5.3	Aranzhimet e reduktimit të ngarkesës.....	52
6.5.4	Fazat e reduktimit të ngarkesës	52
6.5.5	Faza 1	52
6.5.6	Faza 2	53
6.5.7	Faza 3	53
6.6	Aplikimi	53
6.7	Rivendosja e ngarkesës.....	53
6.8	Njoftimet paralajmëruese.....	54
6.8.1	Njoftimet e përgjithshme	54
6.8.2	Forma e njoftimit paralajmërues të rregullimit të ngarkesës	54
6.8.3	Paralajmërimi i verdhë.....	54
6.8.4	Njoftimi paralajmërues i portokalltë	55
6.8.5	Njoftimi paralajmërues i kuq.....	55
6.8.6	Anulimi i njoftimeve paralajmëruese.....	55
6.9	Raportimi pas ndodhisë	55
6.10	Reduktimi nga nënfrekuenca.....	55
6.11	Operimi.....	56
6.12	Reduktimi i ngarkesës me rotacion	56
6.12.1	Rastet e përgjithshme të reduktimit të ngarkesës	56
6.12.2	Plani i reduktimit të ngarkesës me rotacion.....	57
6.12.3	Njoftimi paralajmërues i reduktimit të ngarkesës me rotacion	57

6.12.4	Aplikimi i reduktimit të ngarkesës me rotacion.....	57
6.12.5	Anulimi i reduktimit të ngarkesës me rotacion.....	58
6.12.6	Paralajmërimet e konsumatorëve.....	58
6.13	Kompensimi.....	58
7	Kodi i identifikimit të stabilimentit dhe aparatit	59
7.1	Parathënie.....	59
7.2	Objektivi.....	59
7.3	Fushëveprimi	59
7.4	Procedura	60
7.4.1	Emrat dhe shkurtesat e vendeve.....	60
7.4.2	Identifikimi i stabilimentit dhe aparaturave	60
7.4.3	Aparaturat e reja.....	60
7.4.4	Aparaturat ekzistuese.....	61
7.4.5	Ndryshimet në aparaturat ekzistuese	61
7.5	Obligimi i përkujdesjes.....	62
8	Testimet e sistemit.....	62
8.1	Parathënie.....	62
8.2	Objektivi.....	62
8.3	Fushëveprimi	63
8.4	Përkufizimi i testeve të sistemit.....	63
8.5	Procedura e testeve	64
8.6	Programi i testimit.....	64
8.7	Implementimi i testimit të sistemit.....	64
8.8	Raporti final	65
8.9	Kostot	66

1 Hyrje

1.1 **Kodi Operativ** nuk është një njësi e vetme, por përbëhet nga një numër nën-kodesh të veçanta. Këto nën-kode përbëhen nga:

- a) Kodi i testimit dhe monitorimit
- b) Kodi i ndërlidhjes operative dhe furnizimit me informata të ndodhive
- c) Kodi i koordinimit të sigurisë
- d) Kodi i planifikimit të rasteve të paparashikuara
- e) Kodi i rregullimit të ngarkesës
- f) Kodi i identifikimit të stabilimentit dhe aparaturave
- g) Kodi i testeve të sistemit

2 Kodi i testimit dhe monitorimit

2.1 Parathënie

Ky kod specifikon procedurat që duhet të zbatohen nga **OST** gjatë kryerjes së testimit dhe monitorimit në lidhje me:

- a) Monitorimin e **njësive gjeneruese** kundrejt prodhimit të programuar të tyre;
- b) Monitorimin e **njësive gjeneruese** kundrejt obligimeve të tyre sipas **Kodit të Rrjetit** për rregullimin ngarkesë - frekuencë dhe rregullimin e tensionit/fuqisë reaktive;
- c) Pajtueshmërinë e **përdoruesve** me **kodin e kyçjes** dhe **marrëveshjen e kyçjes** së tyre;
- d) Pajtueshmërinë e tyre me **marrëveshjet e shërbimeve ndihmëse** dhe ofrimin aktual të këtyre **shërbimeve ndihmëse**;
- e) Testimin e **startimit nga errësira (zero)** (shih po ashtu seksionin 5.8.11);
- f) Ndonjë testim tjetër i kërkuar nga dispozitat e **Kodit të Rrjetit**

2.2 Objektivi

Objektivat e këtij kodi janë që të konfirmojnë se **përdoruesit** pajtohen me të gjitha aspektet e **Kodit të Rrjetit** përveç rasteve kur posaçërisht lirohen nga ndonjë aspekt i veçantë dhe që **pjesëmarrësit në treg** të përmbushin detyrimet e tyre të programuara.

2.3 Fushëveprimi

Ky kod aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **Gjeneruesit** duke përfshirë **gjeneruesit** me **njësi gjeneruese** që kanë prodhim më të madh se 5 MW të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**;
- c) **Stacionet gjeneruese të energjisë me erë** me kapacitet të instaluar ≥ 10 MW;
- d) **OSSH-të**;

- e) **Konsumatorët e ngarkesës** të kyçur direkt në **Sistemin e Transmisionit;**
- f) **Furnizuesit.**

2.4 Monitorimi

- 2.4.1 **OST** do të monitorojë performansën e të gjithë **pjesëmarrësve në treg** kundrejt programit final të dërgimit apo pranimit të energjisë të nxjerrë nga plani ditor, pajtueshmërinë e tyre me **kodin e kyçjes** dhe **marrëveshjen e kyçjes** së tyre si dhe me dispozitat e **shërbimeve ndihmëse**.
- 2.4.2 **Përdoruesit** detyrohen të vënë në dispozicion të **OST** të gjitha informatat relevante dhe matjet në kohë reale të nevojshme për të kryer me sukses monitorimin e performansës së cekur në paragrafin 2.4.1.
- 2.4.3 Nëse **OST** vendos se një **pjesëmarrës në treg** vazhdimisht dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij për sa i përket pranimit ose dërgimit të energjisë së tij, përgjigjes ndaj frekuencës ose dispozitave të **shërbimeve ndihmëse**, atëherë **pala** relevante do të informohet nga **OST** në lidhje me dështimet e tij.
- 2.4.4 Në rastin e dispozitave të **shërbimeve ndihmëse**, ose si obligim i detyrueshëm ose sipas **marrëveshjes së shërbimeve ndihmëse**, **OST** ka të drejtë të kërkojë marrjen e shërbimeve shtesë në llogari të **palës** e cila ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj.
- 2.4.5 **Pala** e informuar, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, do t'i japë **OST** një shpjegim të arsyeve të dështimit dhe detajet e masave që propozon të marrë për të qenë e aftë që të përmbushë detyrimet sipas **Kodit të Rrjetit**.
- 2.4.6 **Pala** e përfshirë mund të dëshirojë të ndërmarrë një numër hapash të përkohshëm para vendosjes së zgjidhjes përfundimtare dhe secili nga këta hapa duhet të dakordohet me **OST**.

2.5 Testimi

- 2.5.1 **OST** mundet në çdo kohë t'i kërkojë një **përdoruesi** të kryejë një testim, me kusht që të ketë baza të arsyeshme për ta justifikuar atë.
- 2.5.2 Arsyeja mund të jetë për shkak të një ndryshimi në performansë të lajmëruar nga një **përdorues**, ose monitorimi dhe përfundimi i masave të ndërmarra sipas seksionit 2.4 ose për ndonjë arsye tjetër.

- 2.5.3 Çdo testim që kryhet duhet të jetë vetëm për të konfirmuar , se kushtet në fjalë mund të përmbushen.
- 2.5.4 Në kushte normale **OST** duhet ta njoftojë **palën** e përfshirë së paku dy javë para kohës dhe datës të testimit, por në rrethana të jashtëzakonshme kjo periudhë njoftimi mund të reduktohet në 48 orë.
- 2.5.5 Nëse **pala** e përfshirë e konsideron kohën dhe datën e propozuar të testimit të papërshtatshme, atëherë ajo mund të kërkojë shtyrjen e testimit dhe **OST** duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme që ta përmbushë këtë kërkesë.
- 2.5.6 Testimi duhet të ndërmerret nga **OST** ose nga agjentë që e kryejnë atë testim për interesin e tyre. Megjithatë në të gjitha fazat **pala** së cilës i testohet stabilimenti duhet të jetë prezente në testim.

3 Kodi i ndërlidhjes operative dhe furnizimit me informata të ndodhive

3.1 Parathënie

Ky kod përcakton kërkesat për **palët** të cilat janë të kyçura në **Sistemin e Transmisionit** sikurse më poshtë:

- a) Shkëmbimin e informatave në lidhje me **operimet** dhe/ose **ndodhitë (ngjarjet)** që kanë shkaktuar, do të shkaktojnë ose mund të shkaktojë një ndikim operativ;
- b) Raportimin me shkrim dhe në mënyrë më të plotë, aty ku është e nevojshme, të atyre **incidenteve të mëdha** të cilat fillimisht u raportuan me gojë tek **OST**;
- c) Mekanizmat për shqyrtime të përbashkëta të këtyre ndodhive;

3.2 Objektivi

Objektivat e këtij seksioni në lidhje me një **operim** dhe/ose **ndodhi** janë si më poshtë:

- a) Të sigurojë shkëmbimin e informatave;
- b) Të vlerësojë rreziqet e mundshme që vijnë si rezultat i **operimit** dhe/ose **ndodhisë**;
- c) Të konfirmojë se janë ndërmarrë masat e duhura nga **pala** relevante në mënyrë që të ruhet integriteti i **sistemit**;
- d) Të kryejë shqyrtimet pas **ndodhisë (ngjarjes)**.

3.3 Fushëveprimi

Ky seksion aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **OSSH-të**;
- c) **Gjeneruesit** duke përfshirë **gjeneruesit** me **njësi gjeneruese** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**

- d) **Stacionet gjeneruese të energjisë me erë** me kapacitet të instaluar ≥ 10 MW;
- e) **Konsumatorët e ngarkesës të kyçur direkt në Sistemin e Transmisionit**

3.4 Operimet dhe ndodhitë (ngjarjet)

3.4.1 Kërkesat e përgjithshme

3.4.1.1 Kërkesat e përgjithshme të këtij seksioni janë që të sigurojnë shkëmbimin e lirë dhe në çdo kohë të informacionit dhe për rishikimin dhe shqyrtimet pas incidenteve aty ku është e nevojshme. Këto qëllime synojnë të arrijnë :

- a) Të lejojnë konsiderimin e implikimeve të një **operimi** dhe/ose **ndodhie (ngjarjeje)**;
- b) Të lehtësojnë vlerësimin e ndonjë rreziku të mundshëm që del në pah dhe të mundësojnë ndërmarrjen e masave të duhura në mënyrë që të ruajnë integritetin e **sistemit**;
- c) Të përcaktojnë nivelin e informacionit të detajuar të kërkuar;
- d) Të japin një raport me shkrim të një **operimi** dhe/ose **ndodhie**
- e) Të procedojnë për raportet e incidenteve të mëdha;
- f) Të procedojnë për shqyrtimet e përbashkëta;
- g) Të ruajnë fshehtësinë/transparencën e informacionit;
- h) Të procedojnë për regjistrimin dhe dakordimin e procedurave të vënies në punë.

3.4.1.2 Në përgjithësi **operimet** janë veprime të planifikuara për të cilat **OST** duhet paraprakisht të informohet nga ana e **përdoruesit**. Këto janë veprime që kryhen në mënyrë rutinore por kanë potencial që të ndikojnë në **sistem**.

3.4.1.3 **Ndodhitë** janë incidente ose incidente potenciale të cilat janë të paplanifikuara dhe kanë potencial të ndikojnë në **sistemin energjetik**.

3.4.1.4 Incidentet e mëdha janë **ndodhi** që kanë pasur një ndikim serioz në **sistem** duke dëmtuar më shumë se një **palë** dhe të cilat kërkojnë një shqyrtim.

3.4.2 Mjetet e komunikimit

3.4.2.1 Në mënyrë që të bëhet i mundur komunikimi, të gjitha palët duhet të sigurohen që ata i kanë mjetet e përshtatshme të komunikimit për të lejuar shkëmbimin e informacionit të kërkuar me **OST**. Kërkesat bazë janë si më poshtë:

- a) Një telefon të drejtpërdrejtë, të dedikuar për këtë funksion;
- b) Një Fax;
- c) Një adresë e-maili të dedikuar për këtë funksion.

Përveç këtyre mund të shtohen edhe mjete të tjera të komunikimit ashtu siç përsëritet në **kodin e kyçjes**.

3.4.2.2 Për qendrat e kontrollit të **OSSH**-ve, nënstationet 400kV dhe 220kV, **centralet elektrike dhe përdoruesit e ngarkesës** të lidhur me 110kV ose më tepër, kërkohen dy linja të ndara komunikimi.

3.4.3 Operimet

3.4.3.1 Ndërkohë që në asnjë mënyrë nuk limitojnë kërkesat e përgjithshme të njoftimit që më parë, shembujt e mëposhtëm janë shembuj të operimeve ku njoftimi kërkohet të bëhet në përputhje me këtë seksion:

- a) Operimi i planifikuar i ndonjë **ndërprerësi** ose ndarësi të qarkut ose të ndonjë sekuence, apo kombinimi i të dyjave;
- b) Zbatimi i ndonjë **ndërprerje** të programuar të **stabilimentit** dhe **aparaturave** që janë aranzhuar në përputhje me **kodin e planifikimit të ndërprerjeve**;
- c) Sinkronizimi dhe de-sinkronizimi i **njësive gjeneruese**;
- d) Arritja e nivelit të vetë-dispeçimit nga **njësia gjeneruese**
- e) **Njësia gjeneruese** ndryshon prodhimin për më shumë se 10 MW, nëse nuk është në përputhje me programin e miratuar;
- f) Instruksionet mbi rregullimin e frekuencës dhe **fuqisë aktive**;
- g) Instruksionet mbi rregullimin e tensionit;

- h) Ndryshimet në **sistemin** e mbrojtjes;
- i) Procedurat e vënies në punë.

3.4.3.2 Njoftimi i një **operimi** duhet të ketë detaje të mjaftueshme për të përshkruar **operimin** dhe për t'i mundësuar marrësit të njoftimit që të marrë në konsiderim dhe të vlerësojë në mënyrë të arsyeshme implikimet dhe rreziqet që dalin në pah. Njoftimi do të përfshijë emrin e individit që raporton **operimin** në emër të **OST** ose të **përdoruesit**, sipas rastit. Marrësi mund të bëjë pyetje për t'u sqaruar rreth njoftimit.

3.4.4 Forma dhe koha e një njoftimi të operimit

3.4.4.1 Një njoftim duhet të jepet sa më parë që të jetë praktikisht e mundur dhe në çdo rast do të jepet në kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar marrësit që të konsiderojë dhe vlerësojë në mënyrë të arsyeshme implikimet dhe rreziqet që dalin në pah.

3.4.4.2 Njoftimi do të jepet në formë të shkruar kurdo që të jetë e mundur dhe vetëm nëse nuk ka kohë të mjaftueshme para kohës së programuar për kryerjen e operimit, njoftimi do të bëhet gojarisht. Njoftimet e bëra gojarisht duhet të përforcohen me njoftime në formë të shkruar.

3.4.4.3 Në disa rrethana, njoftimi i shkruar do të përforcohet me një njoftim në formë gojore menjëherë për ndodhinë paraprake.

3.4.4.4 Çdo njoftim i bërë gojarisht vetëm do t'i përsëritet marrësit për të siguruar që ai është kuptuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte.

3.4.4.5 Njoftimet për lëshim në punë do të jepen gjithnjë me shkrim të paktën dy javë më parë dhe do të përforcohen me një njoftim gojor në ditën e operimit.

3.4.5 Ndodhitë

3.4.5.1 Ndërkohë që në asnjë mënyrë nuk limitojnë kërkesat e përgjithshme të njoftimit sa më parë siç përcaktohet në këtë seksion, shembujt e mëposhtëm janë shembuj **ndodhish** ku njoftimi do të kërkohet:

- a) Problemet me **stabilimentet dhe aparaturat** duke përfshirë alarmet, kushtet jonormale të funksionimit dhe ndryshimet e përkohshme të aftësisë;
- b) Dështimet (avaritë) në pajisjet e kontrollit, komunikimit apo matjes;
- c) Problemet me mbrojtjen duke përfshirë pajisjet automatike dhe mbrojtjen nga mbingarkesa duke përfshirë edhe mos-funksionimet e mbrojtjes;

- d) Çdo çrregullim në operimin normal, avaritë dhe rëniet e pajisjeve kryesore;
- e) Çrregullimet në furnizimin me energji elektrike;
- f) Ndërprerjet e programeve të miratuara të **fuqisë aktive** dhe **fuqisë reaktive**;
- g) Paralajmërimet e pamjaftueshmërisë së furnizimit;
- h) Thyerjet e sigurisë ose rreziqet potenciale duke përfshirë aksidentet që ndikojnë tek njerëzit;
- i) Zjarret, ndotja mjedisore dhe **ndodhitë** tjera emergjente të cilat kanë efekt të kundërt ndaj funksionimit normal;
- j) Kushtet e pafavorshme të motit të sprovuara ose të parashikuara.

3.4.5.2 Një njoftim i një **ndodhie** nën këtë seksion duhet të përmbajë detaje të mjaftueshme për të përshkruar **ndodhinë** dhe për t'i mundësuar marrësit të njoftimit që të merr në konsiderim dhe të vlerësojë në mënyrë të arsyeshme implikimet dhe rreziqet që dalin në pah. Njoftimi do të përfshijë emrin e individit që raporton **ndodhinë** në emër të **OST** ose të **përdoruesit**, sipas rastit. Marrësi mund të bëjë pyetje për t'u sqaruar rreth njoftimit dhe **pala** njoftuese do të përpiqet arsyeshmërisht për të dhënë informacionin e nevojshëm.

3.4.6 Forma dhe koha e një njoftimi të ndodhisë

3.4.6.1 Një njoftim i **ndodhisë** duhet të jepet sa më parë që të jetë praktikisht e mundur në mënyrë që t'i jepet kohë e mjaftueshme marrësit që të konsiderojë dhe vlerësojë në mënyrë të arsyeshme implikimet dhe rreziqet e **ndodhisë** së papritur. Në rastin e një **ndodhie** të paplanifikuar apo të papritur njoftimi duhet të jepet sa më parë që të jetë e mundur pas paraqitjes së **ndodhisë**.

3.4.6.2 Njoftimi duhet të bëhet gojarisht dhe me përjashtim të rasteve emergjente, nëse secila **palë** e kërkon, ai do të përsëritet nga marrësi për të siguruar që njoftimi është kuptuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte.

3.5 Paralajmërimet e sistemit

3.5.1 Paralajmërimet e përgjithshme

3.5.1.1 Paralajmërimet e **sistemit** do të kërkohen për të gjitha **incidentet e mëdha**. **Incidentet e mëdha** ndahen në tri kategori. Këto tri kategori përbëjnë dy kategoritë e përshkruara në Politikën 5 të Doracakut të Operimit të **ENTSO-E**, të cilat përshkruajnë

funksionime jonormale të **sistemit** dhe kanë potencial për të shkaktuar një çrregullim dhe një funksionim të paqëndrueshëm të **sistemit**. Këto dy faza – me alarm dhe emergjente – përshkruhen në seksionet e mëposhtme së bashku me masat që duhet të ndërmerren. Kategoria e tretë janë **incidentet e mëdha** që nuk kanë lidhje drejtpërdrejtë me **sistemin energjetik** por mund të shpiejnë në probleme të **sistemit energjetik** nëse nuk ndërmerren masa.

3.5.2 Situatat e alarmit

3.5.2.1 Në këtë situatë **sistemi energjetik** është i qëndrueshëm por të gjitha rezervat operative (për të balancuar transmisionin dhe gjenerimin) duhet të mobilizohen. Nuk është e qartë nëse, ose kur do të jetë e mundur të rikthehen kufijtë e sigurisë. **Sistemi** është i qëndrueshëm dhe funksionon brenda kufijve të pranueshëm të funksionimit por është shumë afër ose sapo ka tejkaluar kufijtë e sigurisë. **Operatorët e Sistemit** kanë pasiguri serioze në lidhje me rikthimin në gjendje normale për shkak të kufizimeve të sistemit ose ngarkesës/gjenerimit dhe situata është potencialisht e rrezikshme.

3.5.2.2 Në situatat e alarmit mund të kenë ndodhur ose mund të ketë rrezik serioz që të ndodhin:

- a) Fikja manuale ose automatike e **stabilimentit dhe aparaturave**;
- b) Tensioni jashtë kufijve normal sipas **kodit të rregullimit të tensionit** në një pjesë të **sistemit**;
- c) **Sistemi** nuk funksionon sipas standardeve të sigurisë;
- d) Jostabiliteti i **sistemit**;
- e) Rreziku potencial i mbingarkesave të **sistemit**.

3.5.3 Situatat emergjente

3.5.3.1 Në këtë situatë **sistemi** nuk është i qëndrueshëm dhe zhvillimi “natyror” për shkak të rënies së kaskadës, rënies së frekuencës, humbjes së sinkronizimit, ndërprerjeve të energjisë, ndarja do ta çojnë atë në një situatë të pasigurt dhe të pakontrollueshme. Rrezikohet siguria globale e gjithë **sistemit energjetik** të interkoneksionit. Mund të jenë të nevojshme masat e jashtëzakonshme të tilla si reduktimi i ngarkesës për të kufizuar shpërndarjen e situatës së rrezikshme dhe për të parandaluar kolapsin e një pjese apo të gjithë **sistemit energjetik**. Në këtë gjendje, **sistemi** shkon me shpejtësi drejt kushteve të funksionimit me rrezik të lartë me parametra jashtë kufijve të sigurisë operative.

3.5.3.2 Në situatat **emergjente** mund të kenë ndodhur ose mund të ketë rrezik serioz që të ndodhin:

- a) Fikja manuale ose automatike e **stabilimentit dhe aparaturave**;
- b) Probleme të gjerësishme me tensionin jashtë kufijve normal sipas **kodit të rregullimit të tensionit**;
- c) Frekuenca e **sistemit** jashtë niveleve për një **ndodhi** të madhe sipas **kodit të rregullimit të frekuencës**;
- d) Jostabiliteti i **sistemit**;
- e) Mbingarkesat e **sistemit**.

3.5.4 Situata tjera serioze

Situata të tjera serioze që kërkojnë një paralajmërim të **sistemit** përfshijnë:

- a) Dështimet serioze të **sistemit** të komunikimit që ndikojnë në funksionimin e tregut ose **sistemit**;
- b) Aksidentet që përfshijnë humbjen e jetës.

3.5.5 Raportimi i incidenteve të mëdha

3.5.5.1 Në rastin e **incidenteve të mëdha** të listuara në seksionet 3.5.2 deri 3.5.4 ku ekziston rreziku i shpërndarjes ose çrregullimit serioz të tërë ose një pjese të **sistemit**, atëherë **OST** do të lëshojë një paralajmërim të **sistemit** për të gjithë **përdoruesit e sistemit** të cilët mund të dëmtohen. Ky paralajmërim duhet të jepet, nëse është e mundur, në formë gojore dhe të shkruar, dhe do të përmbajë informacionin të cilin **OST** e konsideron si të nevojshëm.

3.5.5.2 Gjatë periudhës kur **paralajmërimi i sistemit** është në fuqi, çdo **përdorues** pas marrjes së paralajmërimit të **sistemit** duhet të ndër marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të paralajmëruar stafin e tij operativ për të mbajtur **stabilimentin dhe aparaturën** e vet në kushtet më të mira të mundshme për t'i bërë ballë çrregullimit të pritur.

3.5.5.3 Të gjitha incidentet e mëdha që kërkojnë një paralajmërim të **sistemit** kanë nevojë për një raport në formë të shkruar. Nëse ka mosmarrëveshje në lidhje me faktin nëse një ndodhi përbënë apo jo një incident të madh atëherë ai që vendos është **OST**. Kjo do të aplikohet për **ndodhi** në çdo pjesë të **sistemit energjetik** të Kosovës duke përfshirë **Sistemin e Shpërndarjes**.

- 3.5.5.4 Aty ku një palë njofton **OST** sipas këtij seksioni për një **ndodhi** të cilën **OST** e konsideron që ka pasur ose mund të ketë një ndikim të madh në **Sistemin e Transmisionit, OST** mund t'i kërkojë **palës** që ta raportojë **ndodhinë** në formë të shkruar sipas dispozitave të këtij seksioni. Në këtë rast **OST** do ta informojë **palën** e përfshirë sipas rrethanave.
- 3.5.5.5 Aty ku **OST** njofton një **përdorues** për një **ndodhi** të cilën **përdoruesi** e konsideron si **ndodhi** që ka pasur ose mund të ketë një ndikim të madh tek ai, atëherë **përdoruesi** mund t'i kërkojë **OST** që ta raportojë **ndodhinë** në formë të shkruar sipas dispozitave të këtij seksioni. Në këtë rast **përdoruesi** do ta informojë **OST** sipas rrethanave.
- 3.5.5.6 Në secilin nga rastet e mësipërme, **pala** në **sistemin** e së cilës është paraqitur **ndodhia**, brenda katër orësh do të përgatisë një raport të shkurtër faktik mbi **ndodhinë**. Aty ku kërkohet një raport me shkrim atëherë duhet të fillohet brenda një jave dhe duhet të përfundohet brenda një muaji.
- 3.5.5.7 Aty ku **incidenti i madh** përfshin më tepër se një **sistem** atëherë secila palë duhet të bëjë një raport ose të gjitha palët duhet të bëjnë një raport të përbashkët sipas paragrafit 3.5.6.

3.5.6 Shqyrtimet e përbashkëta

- 3.5.6.1 Aty ku është deklaruar një **incident i madh** dhe është bërë një raport në formë të shkruar nga **OST**, një **OSSH** ose një **përdorues**, secila nga këto palë, mund të kërkojë në formë të shkruar kryerjen e një shqyrtimi të përbashkët të detajuar për atë incident të madh. Gjithashtu çdo **palë** mund të kërkojë që palët e tjera të dëmtuara të përfshihen në shqyrtimin e përbashkët.
- 3.5.6.2 Termat e referencës dhe të gjitha çështjet në lidhje me shqyrtimin e përbashkët do të dakordohen për fillimin e shqyrtimit të përbashkët.
- 3.5.6.3 Shqyrtimi i përbashkët do të fillojë brenda dy javëve nga kërkesa fillestare dhe do të përfundohet brenda dy muajve nga kërkesa fillestare.

3.6 Raportet në formë të shkruar

Qëllimi i përgjithshëm i raportit në formë të shkruar duhet të jetë për të shpjeguar çka ka ndodhur dhe pse ka ndodhur. Raporti duhet t'i përgjigjet pyetjeve kush, çfarë, pse, ku, kur dhe si.

3.6.1 Përmbajtja e raportit në formë të shkruar

3.6.1.1 Raporti edhe kur është si rezultat i një shqyrtimi të përbashkët ose i një shqyrtimi nga një **palë** duhet, si minimum, të përmbajë çështjet e specifikuara në këtë paragraf. Çdo marrës i një raporti në formë të shkruar mund të bëjë pyetje për të sqaruar ndonjë çështje dhe përpiluesi i raportit do t'i kthejë përgjigje rreth këtyre pyetjeve aq sa është e mundur.

3.6.1.2 Përmbajtja e një raporti në formë të shkruar duhet të jetë si më poshtë:

1. Fleta e parë standarde me përmbledhjen ekzekutive;
2. Vendndodhja;
3. Përmbledhja e **ndodhisë**;
4. Data dhe koha e **incidentit të madh**;
5. Lëndimet;
6. Personeli, kontraktuesit dhe publiku i përfshirë;
7. Pajisjet e dëmtuara;
8. Kërkesa dhe/ose prodhimi i ndikuar duke përfshirë MW dhe numrin e konsumatorëve të përfshirë;
9. Ekipi shqyrtues;
10. **Ndodhitë** që çuan tek incidenti;
11. Veprimet e bëra menjëherë pas incidentit;
12. Konkluzionet (kryesore dhe nën-konkluzionet nëse aplikohen);
13. Shkaku i incidentit (i menjëhershëm dhe shkaqet bazë);
14. Rekomandimet;
15. Veprimet e mëtutjeshme.

Shtojcat: Këto duhet të përfshijnë termat e referencës, kopjet e dokumentacionit relevant të tilla si protokollin e kyçje-shkyçjeve, protokollin e **ndodhive**, dokumentacionin e sigurisë, skemat e

sistemit, fotografitë etj. Në mënyrë që të ruhet anonimiteti, kopjet duhet të ndryshohen duke larguar emrat nga raportet të cilat do të qarkullohen gjerësisht.

4 Kodi i koordinimit të sigurisë

4.1 Parathënie

4.1.1 Ky kod specifikon procedurat standarde që do të përdoren nga të gjitha palët të cilat janë të kyçura në **Sistemin e Transmisionit** për koordinimin dhe implementimin e **masave paraprake të sigurisë** që kërkohen për stabilimentet e TL në **sistemet e palëve** tjera në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore kur duhet të kryhet puna dhe/ose testimi.

4.1.2 Ky kod nuk ka për qëllim të paraqes **rregullat e sigurisë specifike** për **OST** dhe **përdoruesit**¹ e tjerë. **OST** dhe secili **përdorues** individual do të zhvillojnë **rregullat e sigurisë** të tyre të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e specifikuar në këtë kod.

4.2 Objektivi

4.2.1 Objektivi i këtij kod është të arrijë parimin bazë të mbrojtjes së personelit kundër ndikimit të **sistemit** gjatë kryerjes së punimeve dhe/ose testimit të **stabilimentit apo aparaturës** që kërkon parashikimin e **masave paraprake të sigurisë** në **sistemin** tjetër në stabilimentet e tensionit të lartë deri në **pikën e kyçjes**.

4.2.2 **Masat paraprake të sigurisë** janë të nevojshme kur kryhen punime dhe/ose teste në **stabilimentin dhe aparaturën e OST** ose të një **përdoruesi** dhe ku kërkohet izolimi (ndarja) dhe/ose tokëzimi i **sistemit** tjetër. Ky kod nuk aplikohet për **testimet e sistemit** ose aty ku **masat paraprake të sigurisë** janë të nevojshme të dakordohen vetëm në mes të **përdoruesve**.

4.3 Fushëveprimi

Ky seksion aplikohet për palët e mëposhtme:

- a) **OSTT**;
- b) **OSSH-të**;
- c) **Gjeneruesit e kyçur në Sistemin e Transmisionit**;
- d) **Stacionet gjeneruese të energjisë me erë** me kapacitet të instaluar ≥ 10 MW (të kyçura në rrjetin e transmisionit);

¹ Në këtë kod **OSSH-të** trajtohen si përdorues të **Sistemit të Transmisionit**.

- e) **Konsumatorët e ngarkesës** të cilët janë drejtpërdrejtë të kyçur në **Sistemin e Transmisionit**;

4.4 Aranzhimet e përgjithshme

4.4.1 Përgjegjësitë e menaxhimit të sigurisë

OST dhe gjithë **përdoruesit** të cilët kryejnë punime dhe/ose testime të tensionit të lartë në **Sistemin e Transmisionit** të Kosovës duhet të kenë një **sistem të menaxhimit të sigurisë** dhe **rregullat e sigurisë** të modeluara për ta mbrojtur personelin nga rreziqet e **sistemit energjetik**. Duke vepruar kështu, të gjitha masat e ndërmarra duhet të jenë në pajtueshmëri me legjislacionin Kosovar.

4.4.2 Sistemi i miratuar i menaxhimit të sigurisë

4.4.2.1 **Sistemi i menaxhimit të sigurisë** do të specifikojë parimet dhe procedurat, dhe aty ku është e përshtatshme, aplikimin e dokumentacionit në mënyrë të tillë që të sigurojë shëndetin dhe sigurinë e të gjithë atyre që janë përgjegjës të punojnë apo testojnë në **Sistemin e Transmisionit** ose në **stabilimentet dhe aparaturat** e kyçur në të. Kjo do të vendoset nga **OST** dhe **përdoruesit** e tjerë të specifikuar në këtë kod.

4.4.2.2 Ky **sistem i menaxhimit të sigurisë** duhet të përfshijë dispozitat për kërkesën dhe regjistrimin e vend shtrirjes së punimeve apo testimeve të nevojshme si dhe **masat paraprake** përcjellëse të **sigurisë** në një **pikë të kyçjes** dhe kohën e njoftimeve që normalisht do të jetë e nevojshme..

4.4.3 Procedura për përshtatjen e rregullave të sigurisë

4.4.3.1 Një kopje e **rregullave të sigurisë** do të shkëmbehet mes secilit **përdorues** dhe **OST** me të cilin ata kanë një **pikë kyçe**, brenda gjashtë muajve nga data e nënshkrimit të **marrëveshjes së kyçjes (MK)** dhe të paktën tre muaj para lëshimit në punë të ndonjë kyçje të re. Para kyçjes, **OST** do të shqyrtoj dhe do të pajtohet me **rregullat e sigurisë** të **përdoruesit** në lidhje me **izolimin** (ndarjen) dhe **tokëzimin**. Çdo ndryshim i **rregullave të sigurisë** të një **pale** do t'i komunikohet të gjitha **palëve** relevante sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Çdo ndryshim i **rregullave të sigurisë** gjithashtu do të rishikohet dhe do të marrë pëlqimin e **OST**.

4.4.3.2 Nëse të gjitha **palët** e përfshira në një **pikë kyçe** përdorin të njëjtën procedurë të menaxhimit të sigurisë dhe të njëjtat **rregulla të sigurisë** atëherë nuk kërkohet shkëmbimi i këtyre dokumenteve.

4.4.4 Kufijtë e punës

Në **pikat e kyçjes**, aty ku ekziston një **kufi operativ, palët** e përfshira do të vendosin së bashku se cili **sistem i menaxhimit të sigurisë** është i pranueshëm,. Në të gjitha rastet, **sistemi i menaxhimit të sigurisë** i miratuar do të mundësoj regjistrimin dhe mirëmbajtjen e **masave paraprake të sigurisë** kur:

- a) Kryhen punime dhe/ose testime në **stabilimentin dhe aparaturat** e tensionit të lartë në kufijtë operativ; dhe
- b) **Izolimi dhe/ose tokëzimi** i **sistemit** të palës tjetër është i nevojshëm.

4.4.5 Koordinatorët e sigurisë

4.4.5.1 **OST** dhe çdo **përdorues** do të emërojnë **koordinatorët e sigurisë** të cilët do të jenë përgjegjës për operimin dhe koordinimin e sigurt të **sistemit të menaxhimit të sigurisë**. Ata do të sigurojnë marrjen e **masave** të duhura **paraprake të sigurisë** . Kjo përfshin proceset e kyçjeve dhe çkyçjeve, **izolimit, tokëzimit** dhe lëshimit të lejes së punës në pajtim me akorduar në **Marrëveshjen e Kyçjes** në mënyrë që të përmbushen afatet kohore të riparimeve me ndikim tek **përdoruesit** tjerë. **Përdoruesit** vetëm operatorët e trajnuar duhet t'i lejojnë për të shkyqur (ndërprerë) dhe për të siguruar qarqe të sigurta para se personat përgjegjës të vijnë në vendin e punës. **Koordinatori i sigurisë** do të jetë përgjegjës për koordinimin e sigurisë sipas këtyre rregullave të koordinimit të sigurisë.

4.4.5.2 Vetëm personat e trajnuar dhe arsimuar si duhet lejohen të marrin rolet e mësipërme në **Sistemin e Transmisionit** të Kosovës. Trajnimet dhe njoftimet rreth sigurisë do të jenë të vazhdueshme dhe në shumë nivele. **OST** dhe çdo **përdorues** ka përgjegjësinë për të siguruar se gjithë personeli relevant kontrollohet dhe testohet rreth **rregullave të sigurisë dhe sistemit të menaxhimit të sigurisë**.

4.5 Procedurat

4.5.1 procedurat e përgjithshme

4.5.1.1 Organizimi i operimeve të sigurta për punimet dhe testimet në pajisjet e TL në **Sistemin e Transmisionit** të Kosovës duhet të jetë në pajtueshmëri me rregullat dhe Ligjet relevante në Kosovë. Këto do të përpilohen nga **OST** dhe të gjithë **përdoruesit** që veprojnë në **Sistemin e Transmisionit** të Kosovës.

4.5.1.2 Procedurat e referuara më lart mbulojnë punimet dhe/ose testimet e brendshme për **OST** ose ndonjë **përdoruesi** ashtu edhe punimet dhe/ose testimet në një **pikë të kyçjes** ku përfshihet më shumë se një **palë**.

4.5.1.3 SCOEI² specifikon masat për kyçje dhe shkyçje, **izolim** (**ndarjen**), **tokëzimin** dhe përgatitjen për lëshimin e lejeve për punimet dhe/ose testimet. Gjithashtu specifikon procedurat që duhet të ndiqen kur përfundohen punimet dhe/ose testimet dhe pajisjet janë të gatshme për t'u rivendosur në punë (shërbim).

4.5.2 Njoftimi

4.5.2.1 Në mënyrë që të akordohet një **ndërprerje** për qëllime punimesh dhe/ose testimesh në një **pikë të kyçjes**, duhet të përgatitet një aplikim me shkrim tek pala tjetër jo më vonë se dy javë para datës në të cilën kërkohet **ndërprerja**. Në mënyrë që të kryhet **ndërprerja** aplikimi duhet të miratohet nga menaxheri teknik i **palës** tjetër. Brenda një jave nga marrja e kërkesës **pala** marrëse duhet të pajtohet me **ndërprerjen** ose do të propozojë një tjetër program kohor.

4.5.2.2 Në rastin e punimeve dhe/ose testeve të paplanifikuara që kërkojnë nivelin e mësipërm të **masave paraprake të sigurisë**, koordinimi i sigurisë mund të aranzhohet nëpërmjet telefonit dhe të konfirmohet me dokumentin standard të kërkesës me kusht që të pajtohen të gjitha **palët** e përfshira.

4.5.3 Implementimi i koordinimit të sigurisë

4.5.3.1 Për secilin **vend të kyçjes** dokumentacioni i duhur për sigurinë do të përgatitet nga **koordinatori kërkues i sigurisë**. Do të përcaktojë masat e nevojshme, duke përfshirë kyçjen/ **shkyçjen**, **ndarjen**, **tokëzimin** dhe masat e nevojshme për ta rivënë pajisjen në punë (shërbim) pas përfundimit të punimeve dhe/ose testeve.

4.5.3.2 Dokumentacioni i sigurisë do të dakordohet nga **koordinatori kërkues i sigurisë** me **koordinatorin implementues të sigurisë**.

4.5.3.3 I gjithë procesi i kyçjeve/shkyçjeve duhet të kryhet në përputhje me renditjen e deklaruar në programet ose formularët për kyçe/shkyçje që përfshijnë marrëveshjen e pikave të **ndarjes** dhe pikave të **tokëzimit**. Kthiminë konfiguracionin (gjendjen) fillestar të pajisjeve përkatëse në shërbim renditja e mësipërme do të kryhet mbrapsht.

² SCOEI – Koordinimi i kyçje shkyçjes, ndarja, tokëzimi (Switching, Coordination, Earthing, Isolation)

4.5.4 Punimet në të dy anët e pikës së kyçjes

Aty ku **masat paraprake të sigurisë** vendosen për të mundësuar kryerjen e punimeve dhe/ose testimeve në të dyja anët e një **pike të kyçjes** atëherë të dyja palët duhet të pajtohen rreth aranzhimeve si dhe duhet të përgatisin dhe lëshojnë dokumentacionin e duhur.

4.5.5 Marrëveshja e ndarjes

4.5.5.1 Sapo qarku ose stabilimenti është de-energizuar të dy koordinatorët e sigurisë do të pajtohen rreth vendit ku duhet të kryhet **ndarja**. Kjo marrëveshje do të regjistrohet me shkrim nga të dy **palët**.

4.5.5.2 Nëse marrëveshja për vendin e **ndarjes** nuk mund të arrihet atëherë punimet nuk mund të fillojnë.

4.5.6 Implementimi i ndarjes

4.5.6.1 Pas marrëveshjes për **masat paraprake të sigurisë** në përputhje me paragrafin 4.5.5, **palët** do të realizojnë **ndarjen**.

4.5.6.2 **Palët** do t'i konfirmojnë njëra tjetrës që ndarja e dakorduar është kryer dhe do të konfirmojnë identitetin e stabilimentit të TL, deri në **pikën e kyçjes**, për të cilin është bërë **ndarja**. Konfirmimi do të specifikoj pikat e mëposhtme:

- a) Identitetin me anë të emrit të stabilimentit të TL, nomenklaturën dhe numërimin, ose pozicionin për secilën pikë të **ndarjes**;
- b) Nëse **ndarja** në pozicionin e ndarjes është bërë me anë të një pajisjeje ndarëse ose me anë të ndarjes adekuate fizike;
- c) Aty ku është përdorur një pajisje ndarëse në pozicionin e ndarjes nënkupton:
 - i) Bllokimin dhe mbylljen me një çelës sigurie i cili ruhet në një kasafortë (sef) dhe kasaforta është nën mbikëqyrje të sigurtë;
 - ii) Mbajtjen e sigurtë të pikës së ndarjes në pozicion të atillë nga ndonjë metodë tjetër e cila duhet të jetë në përputhje me **rregullat e sigurisë** së **palës** relevante
- d) Aty ku është përdorur ndarja adekuate fizike, duhet të konfirmohet se është në përputhje dhe mirëmbahet me metodat e përcaktuara në **rregullat e sigurisë** të **OST** ose të **përdoruesit** sipas rastit.

4.5.6.3 Konfirmimi i **ndarjes** do të regjistrohet në formë të shkruar nga të dy **palët**.

4.5.7 Marrëveshja e tokëzimit

4.5.7.1 Pas konfirmimit të **ndarjes** nga të dy **palët**, **koordinatori kërkues i sigurisë** mund të kërkojë implementimin e **tokëzimit** nga ana e **koordinatorit implementues të sigurisë**. Nëse kjo është e nevojshme, duhet të konfirmohet që **tokëzimi** do të kryhet në vendin e dakorduar më parë. Ky konfirmim do të regjistrohet me shkrim nga të dy **palët**.

4.5.7.2 Nëse marrëveshja për vendndodhjen e **tokëzimit** nuk mund të arrihet atëherë punimet nuk do të fillojnë.

4.5.8 Implementimi i tokëzimit

4.5.8.1 Të dy **koordinatorët e sigurisë** do të vendosin **tokëzimin** e dakorduar dhe do të konfirmojnë që tokëzimi është bërë me sukses. Ata gjithashtu do të konfirmojnë identitetin e stabilimentit të TL të **koordinatorit kërkues të sigurisë**, deri në **pikën e kyçjes**, për të cilën është bërë **tokëzimi**. Konfirmimi do të specifikojë pikat e mëposhtme:

- a) Identitetin me anë të emrit të stabilimentit të TL, nomenklaturës dhe numërimit ose pozicionin për secilën pikë dhe llojin e tokëzimit;
- b) Llojin e pajisjes tokëzuese, nëse është:
 - i. Fiksuar dhe bllokuar në pozicionin e **tokëzuar** dhe ku pajisja e **tokëzimit** është bllokuar dhe mbyllur me një çelës sigurie i cili ruhet në një kasafortë (sef) dhe kasaforta është nën mbikëqyrje të sigurtë.
 - ii. Mbajtur sigurtë pozicioni i tokëzimit në pozicion të atillë nga ndonjë metodë tjetër e cila duhet të jetë në përputhje me **rregullat e sigurisë** së **palës** relevante

4.5.8.2 Konfirmimi i **tokëzimit** do të regjistrohet në formë të shkruar nga të dyja **palët**.

4.5.9 Raportimi i sigurisë

4.5.9.1 Të gjitha veprimet e ekzekutuara nga **koordinatorët e sigurisë** duhet të dakordohen mes tyre dhe duhet t'i raportohen njëri-tjetrit, duke i përsëritur gojarisht fjalë për fjalë dhe të regjistrohen në formë të shkruar nga të dyja **palët**.

4.5.9.2 Të dy **palët** do të dakordohen rreth identitetit të stabilimentit në të cilin janë ndërmarrë **masat paraprake të sigurisë**. Leja e punës e cila do të plotësohet nga **koordinatori kërkues i sigurisë** duhet të plotësojë kërkesat themelore si më poshtë:

- a) Ajo duhet të jetë e lexueshme qartë dhe asnjë shënim me laps apo ndryshim nuk lejohet të bëhet në lejen e punës;
- b) Numri është kompetencë e **OSTT** ose **përdoruesit**;
- c) Datat duhet të përdoren në formatin standard dd-mm-vvvv;
- d) Emrat duhet të përmbajnë inicialet dhe nivelin e autorizimit;
- e) Leja e punës duhet të përmbajë numrin e identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturës**;
- f) Në rast se kërkohet më tepër hapësirë në lejen e punës atëherë mund të përdoret një leje e dytë e punës e cila i referohet asaj të parës;

4.5.10 Autorizimi

Pas nënshkrimit të lejes relevante të punës, është siguruar leja për përgatitjen e vendit të punës dhe vetëm kur **masat paraprake të sigurisë** janë përfunduar atëherë mund të fillojnë punimet. Atëherë **koordinatori kërkues i sigurisë**, mund të autorizojë punimet por jo testimet. Aty ku duhet të kryhen testime, do të implementohet procedura e përcaktuar më poshtë në paragrafin 4.5.11. Procedura për kryerjen e punimeve është plotësisht një çështje e brendshme e **palës** së përfaqësuar nga **koordinatori kërkues i sigurisë**.

4.5.11 Testimet

4.5.11.1 Aty ku **koordinatori kërkues i sigurisë** dëshiron të autorizojë kryerjen e një testimi për të cilin aplikohet **kodi i koordinimit të sigurisë** (brenda **kodit operativ**), ai nuk do të mundet ta bëjë këtë dhe testimi nuk do të kryhet nëse nuk ndiqen procedurat e mëposhtme dhe nëse konfirmimi i përfundimit nuk është regjistruar në formë të shkruar:

- a) Konfirmimi merret nga **koordinatori implementues i sigurisë** thotë cili konfirmon se asnjë person nuk është duke punuar apo testuar ose është i autorizuar të punojë apo testojë ndonjë **stabiliment dhe aparaturë** brenda pikave të **ndarjes** për testimin e propozuar, dhe nuk do të autorizohet ta bëjë këtë derisa testimi i propozuar të jetë përfunduar apo anuluar si dhe

koordinatori kërkues i sigurisë të ketë njoftuar **koordinatorin implementues të sigurisë** për përfundimin apo anulimin e kërkesave;

4.5.11.2 **Koordinatori kërkues i sigurisë** do t'ia rikthejë kontrollin koordinatorit implementues të sigurisë sapo testimi të jetë përfunduar apo anuluar. Nëse para testimit, është e nevojshme heqja e **tokëzimit** me qëllim të testimit dhe ky **tokëzim** nuk riaplikohet më pas, ky fakt do të regjistrohet nga të dy **palët**.

4.5.12 Procedura e rikthimit në gjendjen e mëparshme

4.5.12.1 Pas përfundimit të punimeve dhe/ose testimit **koordinatori kërkues i sigurisë** do t'i raportojë **koordinatorit implementues të sigurisë** për **masat paraprake të sigurisë** të cilat nuk janë më të nevojshme.

4.5.12.2 Secili **koordinatori i sigurisë** do ta regjistrojë këtë në formë të shkruar duke konfirmuar anulimin e nevojës për të siguruar **masat paraprake të sigurisë** të regjistruara dhe si rezultat miratohet heqja e tyre.

4.5.12.3 Renditja e shkyçjeve dhe kyçjeve dhe heqja e **masave paraprake të sigurisë** ekzekutohen ashtu siç janë përcaktuar në planin e miratuar të paraqitur më lartë dhe raportimi protokolohehet për secilën fazë me të njëjtat detaje të përdorura sikurse për aplikimin e tyre.

4.5.12.4 Asnjë **koordinatori i sigurisë** nuk do të udhëzojë heqjen e **izolimit** që bën pjesë në **masat paraprake të sigurisë** derisa të konfirmohet nga njëri tjetri se të gjitha **tokëzimet janë hequr**.

4.5.12.5 Sapo të jetë konfirmuar se i gjithë **tokëzimi** është hequr, **koordinatori implementues i sigurisë** mund të aranzhojë heqjen e **ndarësive**, procedura e arritjes së kësaj është plotësisht një çështje e brendshme e **palës** të cilën e përfaqëson **koordinatori implementues i sigurisë**.

4.6 Kërkesat e ndërlidhura

4.6.1 Humbja e integritetit (besueshmërisë) të masave parandaluese

Në të gjitha rastet kur ndonjë **masë paraprake** e sigurisë bëhet joefikase për ndonjë arsye, **koordinatori implementues i sigurisë** do të informojë pa vonesë **koordinatorin kërkues të sigurisë** rreth situatës dhe sipas kërkesës edhe arsyetimin.

4.6.2 Siguria mjedisore

4.6.2.1 Do të bëhen aranzhimet e duhura për të siguruar plotësimin e sigurisë mjedisore në vend sipas standardeve të sigurisë.

4.6.2.2 Të gjitha **palët** do të sigurojnë që personeli të paralajmërohet me anë të mjeteve të duhura, rreth rrezikut specifik për secilin vend para se ata të hyjnë në ndonjë pjesë të vendit të punimeve. Ky do të përfshijë rreziqet të cilat mund të jenë të përkohshme ose të përhershme. Aty ku rreziqet përfshijnë kontaminimin ose diçka të ngjashme, duhet të sigurohen mjetet dhe procedurat e përshtatshme de-kontaminuese.

4.6.3 Inspektimet

Do të bëhen aranzhime për të lehtësuar inspektimet nga ana e menaxhmentit të **palëve** relevante dhe nga ana e përfaqësuesve të sigurisë në vendet e kyçjes.

4.6.4 Kontrolli i sistemit

OST dhe **përdoruesit** së bashku do të pajtohen dhe do të përcaktojnë në formë të shkruar programet (oraret) që specifikojnë përgjegjësitë për kontrollin e pajisjeve të **sistemit** . Këto do të sigurojnë që vetëm një **palë** do të jetë përgjegjëse për çdo pjesë (njësi) të **stabilimentit apo aparaturave** në çdo kohë.

4.6.5 Përgatitja e dokumentacionit

4.6.5.1 **OST** dhe **përdoruesit** do të mbajnë një sistem të përshtatshëm të dokumentacionit që regjistron të gjitha **ndodhitë** relevante operative që kanë ngjarë në **Sistemin e Transmisionit** ose në ndonjë sistem tjetër të lidhur me të dhe koordinimin e **masave paraprake të sigurisë** relevante për punimet dhe/ose testimet.

4.6.5.2 **OST** dhe **përdoruesit** do ta mbajnë gjithë dokumentacionin relevant të **koordinimit të sigurisë** sipas këtij kodi duke përfshirë një regjistrim kronologjik të të gjitha mesazheve (njoftimeve, raporteve) në lidhje me të dhe detajet e **masave paraprake të sigurisë** që janë ndërmarrë për punimet dhe/ose testimet, për një periudhë kohore prej jo më pak se pesë vjet.

4.6.6 Diagramet (skemat) e sistemit

OST dhe **përdoruesi** i caktuar do të shkëmbejnë diagramet (skemat) që ilustrojnë informacion të mjaftueshëm për personelin e kontrollit në mënyrë që ata të kryejnë detyrat e tyre.

4.6.7 Komunikimet

4.6.7.1 Aty ku **OST** specifikon nevojën në mënyrë të arsyeshme, sistemet e përshtatshme të komunikimit do të vendosen mes **OST** dhe **përdoruesve** për të siguruar që funksioni i kontrollit të kryhet në mënyrë të sigurt

4.6.7.2 Aty ku **OST** vendos në mënyrë të arsyeshme se është e nevojshme regjistrimi i komunikimit ose mënyrë tjetër komunikimi për të siguruar funksionimin e sigurt të **Sistemit të Transmisionit**, do të akordohen me **përdoruesin** e përshtatshëm.

4.6.7.3 Lista e numrave të telefonit dhe shenjate thirrjeve do të shkëmbehen mes **OST** dhe **përdoruesve** për të mundësuar koordinimin efikas të aktiviteteve të kontrollit.

4.6.7.4 **OST** dhe **përdoruesit** do ta kenë shërbimin 24 orësh të personelit të autorizuar, aty ku kërkesat e funksionimit të përbashkëta operacionale e kërkojnë atë.

5 Kodi i planifikimit të rasteve të paparashikuara

5.1 Parathënie

5.1.1.1 **Kodi i planifikimit të rasteve të paparashikuara** përcakton përgjegjësitë dhe procedurat për kushtet (masat) e rasteve të paparashikuara dhe planet e rikthimit pas rënjes totale ose të pjesshme të **sistemit** në mënyrë që të bëhet i mundur rikthimi i **ngarkesës** totale në kohën më të shkurtër të mundshme duke marrë në konsideratë mundësitë e **centralit elektrik** dhe pengesat operative të **sistemit**.

5.1.1.2 **Kodi i planifikimit të rasteve të paparashikuara** përfshin planin e mbrojtjes, organizimin dhe kërkesat teknike për mbrojtje duke përfshirë mbrojtjen nga frekuenca e lartë/e ulët, **reduktimin** nga **nënfrequenca**, mbrojtjen nga mbi/nën-tensioni dhe komunikimin dhe kontrollin. Gjithashtu mbulon aranzhimet për startimin nga errësira duke përfshirë **planin e startimit nga errësira** dhe testimin e tij dhe kërkesat për një plan për t'u kujdesur ndaj humbjes së qendrës së kontrollit të **OST**.

5.2 Objektivi

Objektivi i përgjithshëm i këtij kodi është që të sigurojë:

- a) Mekanizmat mbrojtës aq sa të jetë e mundur që të shmanget kollapsi i **sistemit**;
- b) Procedurat e rikthimit të sistemit energjetik në gjendjen e mëparshme pas një rënie (fikje) totale apo të pjesshme të **sistemit**;
- c) Planet e akorduara të rikthimit në gjendjen e mëparshme mes të gjitha **palëve** të përfshira;
- d) Vendorsjen e procedurave të akorduara të koordinimit me OST-të fqinje në trajtimin e rasteve të paparashikuara
- e) Të sigurojë që të gjitha mënyrat dhe aranzhimet e komunikimit janë në dispozicion ti mundësojnë përfaqësuesve të lartë menaxhues të **OST** dhe **përdoruesve** që janë përfshirë ose mund të përfshihen në një çrregullim aktual ose serioz potencial apo të përhapur gjërësisht të **sistemit** që kërkon ose mund të kërkojë reagimin urgjent të menaxhmentit të lartë, 24 orë në ditë që të marrin vendime për një emergjencë të tillë.

5.3 Fushëveprimi

Ky seksion aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh)**;
- c) **Gjeneruesit**, duke përfshirë edhe **gjeneruesit** me **njësi gjeneruese** të lidhura me **Sistemin e Shpërndarjes**;
- d) **Stacionet gjeneruese të energjisë me erë** me kapacitet ≥ 10 MW (përveç paragrafit 5.5.2.7)
- e) **Përdoruesit e ngarkesës** të lidhur drejtpërdrejt në **Sistemin e Transmisionit**:

5.4 Mekanizmat mbrojtës

5.4.1 Në një **sistem** kompleks, çrregullimet mund të përhapen në një pjesë të madhe brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe. Çfarëdo masash që të aplikohen në funksionimin e **sistemit**, dukuria afatshkurtër e kushteve operative me pasiguri të lartë nuk mund të kontrollohet dot. Është e mundur që një incident i thjeshtë të shpie shumë shpejtë në një prishje me përmasa të mëdha. Efekti negativ i çrregullimeve në **Sistemin Energjetik** të Kosovës mbi **sistemet** fqinje të interkonektuara që operojnë paralelisht duhet të jetë sa më i kufizuar që të jetë e mundur. Operatorët e sistemit, si rezultat nevojitet të aplikojnë çdo masë të kërkuar për të siguruar, aq sa është e mundur, që pasojat e këtij lloji të incidentit të parandalohen. Për ta siguruar këtë kërkohet vendosja e masave efikase të ruajtjes dhe **plani mbrojtës**.

5.4.2 **OST** është përgjegjës për sigurimin dhe funksionimin paralel të qëndrueshëm të **sistemit energjetik** në pajtueshmëri me rregullat e **ENTSO-E** dhe duhet të përgatisë një **plan mbrojtës** që detajon hapat kryesor që ka ndërmarrë për ta siguruar këtë. **OST** është i detyruar ta koordinojë planin e vet mbrojtës me **OSSH-të** dhe me gjithë **përdoruesit**. Masat në **planin mbrojtës** janë të detyrueshme për të gjitha **palët**.

5.4.3 **Plani mbrojtës** përfshin:

- a) Listën e masave që do të aplikohen në rrethana të ndryshme;
- b) Procedurat e paralajmërimit të **sistemit** sipas **kodit të ndërlidhjes operative dhe tëfurnizimit me informata të ndodhive**;
- c) Parimet dhe organizimi i sistemit mbrojtës;
- d) Kërkesat e pajisjeve teknike;
- e) Përcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe detyrimeve mes **OST** dhe **përdoruesve**;

5.5 Organizimi i sistemit të mbrojtjes rele

OST ka përgjegjësinë që të sigurojë që **Sistemi i Transmisionit** është i mbrojtur mirë dhe si duhet. **Sistemet** dhe pajisjet e mbrojtjes rele të përdorura në rrjet duhet t'i kenë kërkesat të detajuara si më poshtë.

5.5.1 Sistemet e mbrojtjes rele

5.5.1.1 Në mënyrë që të parandalohet përhapja dhe përkeqësimi i një incidenti, duhet të instalohen pajisjet e mbrojtjes adekuate për eliminimin e shpejtë të prishjeve që kanë ndikim në çdo pajisje të **sistemit energjetik**.

5.5.1.2 Mbrojtja në këtë kontekst përfshin pajisjen sinjalizuese të mbrojtjes dhe komunikimin në lidhje me të.

5.5.1.3 Në mënyrë që të sigurohet rikyçja e shpejtë e linjave ajrore pas prishjeve kalimtare, të gjitha qarqet duhet të pajisen me pajisje për kyçje të sërishme automatike (KSA).

5.5.1.4 Kërkesat për operim, shpejtësi të operimit dhe numrin e mbrojtjeve rele në secilin qark përcaktohen detajisht në **kodin e kyçjes**.

5.5.2 Stabiliteti dhe mbingarkesa e rrjetit

5.5.2.1 **Sistemi i Transmisionit** gjithmonë, përveç në situatat emergjente, duhet të funksionoj konform si më poshtë:

- a) Në përputhje me tensionet maksimale dhe minimale të lejueshme dhe ngarkesat maksimale të **sistemit**;
- b) Rrymat maksimale në pajisjet e sistemit dhe rrymave të lidhjeve të shkurta të dakorduara në nyjet e sistemit dhe në ndërlidhjet;
- c) Operimi i një profili të tensionit në rrjet i cili është i balancuar aq sa është e mundur dhe në përgjithësi i lartë në mënyrë që të reduktohen humbjet e transmisionit dhe të përmirësohet stabiliteti i **sistemit**.

5.5.2.2 Në funksionim normal, **sistemi** duhet t'i ketë karakteristikat e mëposhtme:

- a) Furnizon të gjithë konsumatorët;
- b) Të gjitha vlerat kufitare janë nën monitorim (p.sh. s'ka mbingarkesa);
- c) **Kriteri (n-1)** plotësohet në të gjitha pikat.

5.5.2.3 Mbatja e kriterëve të mësipërme do të sigurojë që për të gjitha ndodhitë e besueshme **sistemi** do të mbetet i qëndrueshëm dhe nuk do të pëson nga mbingarkesat. **OST** do të kryejë studimet e sigurisë në baza rutinore dhe sipas rastit për të siguruar që siguria e **sistemit** është arritur, si dhe për të kontrolluar çdo pengesë funksionimi në lidhje me

kushtet e pazakonshme ose jonormale të operimit. Rezultatet e atyre studimeve do t'i komunikohen **Rregullatorit** në rast të ndonjë pengese serioze.

- 5.5.2.4 Të gjitha elementet e **sistemit** të cilat janë nën rrezikun e dëmtimit si pasojë e mbingarkesës duhet të pajisen me mbrojtje kundër mbingarkesës. Por nuk është e domosdoshme për pajisjet që në afatin e shkurtër mund të shkarkohen nga veprimet e dispeçimit.
- 5.5.2.5 **OST** duhet të sigurojë planifikimin e operimit dhe instalimit të mbrojtjeve rele për të siguruar funksionimin e **sistemit energjetik**. Por duhet pasur kujdes për prishjet e shumta që mund të ndodhin dhe gjithashtu për të parandaluar përhapjen e prishjeve në kaskadë.
- 5.5.2.6 **Njësitë gjeneruese** duhet të pajisen me rele mbrojtëse kundër humbjes së sinkronizimit. Këto mbrojtje janë të dizajnuara ta nxjerrin nga puna **njësinë gjeneruese** në rastin e humbjes së sinkronizimit me sistemin kryesor.
- 5.5.2.7 Të dhënat nga linjat ndërkombëtare ndërkufitare dhe linjat tjera ndërshtetërore duhet të vihen në dispozicion përmes kushteve të **marrëveshjeve të interkonekcionit**.

5.5.3 Mbrojtja nga frekuenca e lartë /e ulët

- 5.5.3.1 **Sistemi energjetik** operohet për të mbajtur frekuencën brenda kufijve normal 49.95 deri në 50.05 Hz dhe për të përmbushur kërkesat e **kodit të standardeve elektrike**. Aranzhimet për rregullimin e frekuencës në Kosovë definoohen në **kodin e rregullimit të frekuencës**. Frekuenca jashtë kufijve të pranueshëm shpie në devijim të cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe gjithashtu mund të shpie në dëmtime të mundshme të stabilimentit.
- 5.5.3.2 Kur frekuenca është jashtë diapazonit 49.95 deri në 50.05 Hz atëherë janë të nevojshme masat e rregullimit për të rivendosur frekuencën brenda kufijve normal.
- 5.5.3.3 Në rastin kur frekuenca bie nën 49.50 Hz do të merren masat e emergjencës të detajuara në Tabelën 1 të **kodit të planifikimit të rasteve të paparashikuara**.
- 5.5.3.4 Në rastin kur frekuenca rritet mbi 50.50 Hz do të merren masat e emergjencës të detajuara në Tabelën 2 të **kodit të planifikimit të rasteve të paparashikuara**.

Tabela 1 – Veprimet për frekuencën e ulët të sistemit

Frekuenca	Veprimi
>49.98 Hz	Kufiri operativ normal (akordohet aktivizimi i rregullimit primar të frekuencës)
49.80 Hz	Akordohet aktivizimi i plotë i rezervës së rregullimit primar të frekuencës
49.75 Hz	Personeli vihet në alarm dhe aktivizohen kapacitetet gjeneruese ende të pa-aktivizuara
49.50 Hz	Aktivizohen masat shitesë për rregullimin ngarkesë-frekuencë p.sh. rregullimi i ngarkesës
49.00 Hz	Faza e parë e reduktimit të menjëhershëm nga nënfrekuenca
48.80 Hz	Faza e dytë e reduktimit të menjëhershëm nga nënfrekuenca
48.40 Hz	Faza e tretë e reduktimit të menjëhershëm nga nënfrekuenca
48.00 Hz	Faza e katërt e reduktimit të menjëhershëm nga nënfrekuenca
47.50 Hz	Shkyçja e centraleve elektrike nga sistemi
	KOLAPSI TOTAL I SISTEMIT

Tabela 2 – Veprimet për frekuencën e lartë të sistemit

Frekuenca	Veprimi
< 50.20 Hz	Kufiri normal operativ (>50.02 Hz aktivizohet rregullimi primar i frekuencës)
50.20 Hz	Akordohet aktivizimi i plotë i rezervës së rregullimit primar të frekuencës
50.50 Hz	Zvogëlimi manual i prodhimit të njesisë gjeneruese
51.50 Hz	Fillimi i ndaljes manuale të njësive gjeneruese

5.5.4 Reduktimi nga nënfrekuenca

5.5.4.1 **OST** ka përgjegjësinë për strategjinë e aranzhimeve të **reduktimit nga nënfrekuenca**, në pajtueshmëri me dispozitat nga **Kodi i rregullimit të ngarkesës**. Kjo përfshin marrjen e vendimeve të mëposhtme:

- a) Sasitë e përgjithshme të **ngarkesës** që do të reduktohen në secilin hap të frekuencës;
- b) Frekuencat në të cilat **ngarkesa** duhet të reduktohet;
- c) Vonesat kohore, nëse ka të tilla, që do të vendosen për secilin hap të frekuencës;
- d) Shumën e **ngarkesës** që do të reduktohet nga **konsumatorët e ngarkesës** dhe secili **OSSH** për secilën vlerë të frekuencës;
- e) Koordinimin e planit të **reduktimit nga nënfrekuenca** me **OST**-të fqinje të kyçura direkt dhe indirekt.

5.5.5 Mbrojtja nga mbitensioni

Mbrojtja nga mbitensioni me qëllim të mbrojtjes të pajisjeve elektrike të **Sistemit Energjetik** kundër tensioneve të larta - mbitensioneve ka aplikim të kufizuar në **Sistemin Energjetik** të Kosovës dhe zbatohet vetëm në numër të kufizuar rastesh.

5.5.6 Mbrojtja nga nëntensioni

5.5.6.1 Një rënie e madhe e tensionit mund të vë në rrezik edhe stabilitetin e operimit paralel të **sistemit energjetik**. Stabiliteti i **njësisë gjeneruese** mund të ç'rregullohet dhe rreziku i humbjes nga sinkronizimi mund të rritet.

5.5.6.2 Rënia e tensionit ka shumë gjasa të ndodhë si rezultat i pamjaftueshmërisë së **fuqisë reaktive**. Mungesa e madhe e **fuqisë reaktive** mund të shpie në një rënie të tensionit duke shkaktuar avari të madhe të prodhimit të energjisë që do të ketë ndikim në një numër të madh konsumatorësh.

5.5.6.3 **OST** gjithmonë do të sigurojë furnizimin me **fuqi reaktive** të mjaftueshme në pikat e përshtatshme të **sistemit** sipas **kodit të rregullimit të tensionit**.

5.5.6.4 Në rastin kur ka probleme me tensionin, atëherë masat emergjente mund të përfshijnë alternativa tjera të prodhimit nga **njësitë gjeneruese** tjera, me kyçjen e stabilimentit statik të kompensimit reaktiv dhe shkyçjen e **ngarkesës**.

5.5.7 Komunikimet dhe kontrolli

Humbja e lidhjeve telekomunikuese ose e **sistemeve** të kontrollit nuk duhet të ndikojë në funksionimin e **sistemit energjetik**. Planet e rasteve të paparashikuara duhet të jenë në dispozicion në mënyrë që kontrolli të mund të transferohet në një vend tjetër në një situatë emergjente.

5.6 Parashtrimi i kërkesave të mbrojtjes

OST ka përgjegjësinë që **Sistemi i Transmisionit** të jetë i mbrojtur si duhet. Mbrojtja duhet të sigurohet për t'u mbrojtur nga të gjitha llojet e prishjeve. **Sistemet** e mbrojtjes rele dhe pajisjet e përdorura në sistem duhet të jenë konform me të paktën kërkesat e parashtruara në paragrafët e mëposhtëm.

5.6.1 Kërkesat kryesore

5.6.1.1 Pajisjet mbrojtëse duhet të kenë karakteristikat kryesore si më poshtë:

- a) Ndjeshmërinë – aftësinë për të zbuluar një prishje;
- b) Shpejtësinë – mundësinë e çkyçjes së elementit në prishje nga **Sistemi i Transmisionit** sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që të minimizohen efektet shkatërruese të prishjes duke përfshirë shmangien e humbjes së sinkronizmit të **njësive gjeneruese**.
- c) Selektivitetin – mundësinë që mbrojtja të çkyç nga **Sistemi Energjetik** vetëm elementin në prishje;
- d) Besueshmërinë – aftësinë e funksionimit për prishje të brendshme dhe të jetë stabil për prishje të jashtme dhe gjithashtu sigurimin e funksionit rezervë të mbrojtjes aty ku duhet.

5.6.2 Eliminimi i prishjeve

Sistemi i mbrojtjes rele duhet të funksionoj përmes ndërprerësve të qarkut për të çkyçur në mënyrë automatike elementin në prishje nga pjesa tjetër e **sistemit**.

5.6.3 Analiza e prishjeve

Sistemi i mbrojtjes duhet të lehtësojë procesin e grumbullimit dhe analizës të të dhënave mbi prishjen në **sistem** duke përfshirë informacionin mbi operimet dhe statusin e sistemeve të mbrojtjes rele.

5.6.4 Diskriminimi

Secili element i një instalimi energjetik duhet të ketë mbrojtjen e modeluar e cila do të reagon ndaj prishjeve në gjithë elementin e mbrojtur në kufijtë kohor për të lejuar diskriminim korrekt.

5.6.5 Mbrojtja rezervë

5.6.5.1 Në rastin e dështimit të mbrojtjes kryesore ose ndërprerësit të qarkut të elementit gjegjës, duhet të sigurohet mbrojtja rezervë.

5.6.5.2 Aty ku mbrojtja kryesore është një mbrojtje e vetme (p.sh. mbrojtja mbirrymore), atëherë sistemi i mbrojtjes rezervë duhet të instalohet për të siguruar mbrojtjen rezervë lokale dhe nga distanca.

5.6.6 Teknologjia e re

5.6.6.1 Aty ku është e mundur duhet të aplikohet teknologjia e fundit në mënyrë që të arrihen disa ose të gjitha nga përfitimet e mëposhtme:

- a) Pajisjet për vetë-verifikim dhe vetë-kontroll;
- b) Redukton kërkesat për mirëmbajtje preventive;
- c) Ngarkesa e reduktuar e energjisë;
- d) Pajisjet më kompakte;
- e) Mundësia e kombinimit të disa funksioneve të ndara në një pajisje fizike të vetme - pajisje multifunksionale.

5.6.6.2 Gjatë komisionimit të stabilimenteve të reja dhe rehabilitimit të stabilimenteve ekzistuese duhet të merren në konsiderim:

- a) Përdorimi i sistemeve digjitale moderne të programuara, të automatizuara të mbrojtjes rele, që kombinojnë funksione të tilla si mbrojtja për regjistrim të **ndodhive** dhe përcaktim të vendit të prishjes;
- b) Integrimi i sistemeve të mbrojtjes rele në sistemet me disa nivele të ndërtuara kohëve të fundit me pajisje që kanë mundësi të mbledhjes së informatave nga distanca, dhe analizimin e informacionit, që përcaktojnë parametrat teknik dhe karakteristikat e operimit.

5.6.7 Mbrojtja e linjës së transmisionit

- 5.6.7.1 Për të gjitha linjat e transmisionit aranzhimet e mbrojtjes duhet të sigurojnë që nëse një sistem del nga shërbimi, prishja në atë linjë mund të eliminohet nga të paktën dy sisteme tjera, njëri prej të cilëve mund të mos jetë i asaj linje.
- 5.6.7.2 Për linjat 400 kV duhet të ketë dy mbrojtje kryesore dhe secila prej tyre duhet të sigurojë eliminim shumë të shpejtë të prishjes për 100 % të gjatësisë së linjës.
- 5.6.7.3 Për linjat 110 kV dhe 220 kV duhet të ketë një sistem kryesor mbrojtës që siguron eliminim shumë të shpejtë të prishjes për 100% të gjatësisë së linjës, vetëm nëse kjo nuk kërkohet për arsye të stabilitetit, dhe një mbrojtje rezervë.
- 5.6.7.4 Nëse mbrojtja mbi-frekuente ose mbrojtja diferenciale gjatësore përdoret si sistem kryesor i mbrojtjes, atëherë sistemet e mëposhtme të mbrojtjes duhet të përdoren si rezervë.
- 5.6.7.5 Regjistruerit digjital të **ndodhive**, prishjeve dhe të luhatjeve, dhe përcaktuesit e vendit të prishjes, duhet të sigurohen për të gjitha linjat 400 kV dhe 220 kV dhe për të gjitha nënstacionet 110 kV.

5.6.8 Mbrojtja e autotransformatorëve 400 kV dhe 220 kV

Për të siguruar besueshmërinë e nevojshme për këta transformatorë duhet të instalohen dy mbrojtje diferenciale. Këto mbrojtje nuk do të sigurojnë mbrojtje për prishjet nga jashtë. Por mbrojtja rezervë duhet të siguroj transformatorin për prishjet nga jashtë edhe për qarqet e tjera.

5.6.9 Mbrojtja e zbarës

- 5.6.9.1 Për të rritur besueshmërinë, për të parandaluar sforcimet dhe ruajtjen e stabilitetit dinamik dhe për të përmirësuar aranzhimet për mbrojtjen rezervë të linjave, do të instalohen dy sisteme të mbrojtjes diferenciale për sistemin 400 kV.
- 5.6.9.2 Për zbarat 110 kV dhe 220 kV duhet të instalohet vetëm një mbrojtje diferenciale për secilin seksion të zbarës dhe një mbrojtje rezervë.

5.6.10 Mbrojtja nga defektet e ndërprerësit të qarkut

- 5.6.10.1 Mbrojtja nga ngecja - prishja e ndërprerësit të qarkut duhet të hapë të gjithë ndërprerësit e qarkut që ndodhen pranë ndërprerësit në prishje dhe njëkohësisht të pengojë rikyçjen automatike të ndërprerësve.

5.6.10.2 Mbrojtja nga ngecja e ndërprerësit të qarkut duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që gjatë operimit aksidental aq sa të jetë e mundur të mos ndërpresë qarqet tjera të afërta.

5.6.10.3 Mbrojtja nga ngecja e ndërprerësit duhet të sigurohet për të gjitha qarqet prej 110 kV e më lartë sipas rregulloreve (ekzistuese) në Kosovë.

5.6.11 Aranzhimet (tarimet) e mbrojtjes

5.6.11.1 Aranzhimet e mbrojtjeve të linjave të interkonekcionit do të dakordohen mes **palëve** në interkonekcion në mënyrë që të sigurohet stabiliteti dhe siguria e **sistemeve** të përfshira në mënyrë individuale po ashtu edhe kolektive. **OST** është përgjegjës për zgjidhjen korrekte të aranzhimeve të mbrojtjes rele për **Sistemin e Transmisionit të Sistemit Energjetik** të Kosovës.

5.6.11.2 Zgjedhja e aranzhimeve të mbrojtjeve duhet të synojnë:

- a) Ndarjen e shpejtë dhe të sigurtë nga **sistemi** të elementit të mbrojtur nga çdo lloj i prishjes;
- b) Lejimin e rrjedhave të lejuara të energjisë në tërë elementët e **Sistemit të Transmisionit** në kushtet e operimit normal, gjatë riparimit dhe pas rasteve emergjente pa pasur pengesa në funksionim;
- c) Mbrojtje rezervë për të mbuluar dështimin eventual të mbrojtjes ose ngecjen e ndërprerësit;
- d) Kycjen e sërishme automatike të ndërprerësit të qarkut në të dy anët e linjës së TL pas eliminimit të prishjes;
- e) Sigurimin e stabilitetit dinamik në të gjitha kushtet dhe mënyrat e operimit.

5.6.11.3 Zgjedhja, koordinimi dhe ndryshimi i aranzhimeve të mbrojtjes duhet të kryhet si më poshtë:

- a) Gjatë komisionimit të **centraleve elektrike** të reja, nënstacioneve të reja etj;
- b) Gjatë renovimit - rehabilitimit të sistemeve të mbrojtjeve rele;
- c) Në rast se detektohet ndonjë gjendje apo konfigurim jonormal i **sistemit**.

5.6.11.4 Çdo devijim nga ato që u thanë më sipër do të lejohet vetëm me marrëveshjen specifike të **OST**.

5.6.12 Mirëmbajtja e mbrojtjes rele

Të gjitha sistemet e mbrojtjes rele do të testohen në mënyrë të rregullt dhe do të mirëmbahen në bazë të rregullave të operimit dhe standardeve të mirëmbajtjes.

5.7 Masat manuale emergjente

5.7.1.1 Përgjegjësia thelbësore e **OST** është të mirëmbajë integritetin e **Sistemit Energjetik** të Kosovës. Mund të ketë raste kur **OST** duhet të marrë masa emergjente për reduktimin e ngarkesës në mënyrë që të ruajë integritetin e gjithë **sistemit**.

5.7.1.2 Në rastin kur kërkohen këto masa, **OST** do të lëshojë një udhëzim mbi reduktimin emergjent të ngarkesës. Kur lëshohet një udhëzim mbi reduktimin emergjent të ngarkesës, përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë si më poshtë:

- a) **OST** do të japë një udhëzim të qartë, i cili fillon me një deklaratë që shpjegon se ky është një udhëzim mbi reduktimin emergjent të ngarkesës. Udhëzim mbi reduktimin emergjent të ngarkesës është udhëzim i detyrueshëm dhe do të detajojë sasinë e kërkuar të reduktimit të energjisë. Udhëzimi i reduktimit emergjent të ngarkesës do të lëshohet vetëm nga **OST** kur masat e dhëna në udhëzim duhet të ndërmerren menjëherë;
- b) Një **përdorues** që merr një udhëzim mbi reduktimin emergjent të ngarkesës do t'i bindet menjëherë urdhërit. E vetmja rrethanë që i lejon **përdoruesit** i cili merr një udhëzim mbi reduktimin emergjent të ngarkesës që të mos e marrë parasysh atë, është kur i rrezikohet jeta;
- c) Udhëzimet për reduktimin emergjent të ngarkesës do t'i kopjohen edhe **Rregullatorit**.

5.8 Startimi nga errësira

5.8.1 Rënia totale

Rënia totale është gjendja kur i gjithë **gjenerimi** është ndalur dhe nuk ka furnizim me energji, gjë që e bën **Sistemin Energjetik** të paafte të funksionojë normalisht dhe të pësojë rënie totale. Në këto rrethana nuk është e mundur që **sistemi** të fillojë të funksionojë përsëri pa udhëzimet nga **OST** që kanë të bëjnë me procedurën e **startimit nga errësira**.

5.8.2 Rënia e pjesëshme

Rënia e pjesëshme është e njëjtë me **rënie totale** por në këtë rast i gjithë **gjenerimi** është ndërprerë në një pjesë të veçantë të **sistemit energjetik** dhe nuk ka furnizim me energji elektrike nga pjesët e tjera të **sistemit energjetik** për atë pjesë të sistemit. Rezultati është që ajo pjesë e **sistemit energjetik** nuk mund të funksionoj normalisht dhe është jashtë operimit.

5.8.3 Rëniet totale ose të pjesshme

Gjatë një **rënie totale** ose një **rënie të pjesshme** dhe gjatë rikthimit të pjesshëm në punë, standardet normale të sigurisë të përcaktuara në **kodin operativ** ose në **kodin e standardeve të energjisë elektrike** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës mund të mos aplikohen. Në një **rënie totale** tregu do të pezullohet dhe do të rivendoset kur të vendosë **OST**. Në një **rënie të pjesshme** tregu nuk do të funksionojë në atë pjesë të **sistemit** që është jashtë operimit derisa të vendosë **OST**. **OST** mund të pezullojë tregun gjithashtu në pjesët tjera të **sistemit** të cilat nuk janë jashtë operimit.

5.8.4 Njoftimi

5.8.4.1 Në rastin e një **rënies totale**, **OST** do të informojë **Rregullatorin** dhe të gjithë **përdoruesit** dhe **palët e interkonektuara** të cilat sipas mendimit të **OST** nevojitet të informohen, rreth **rënies totale** dhe se **OST** do të zbatoj procedurën e **startimit nga errësira**.

5.8.4.2 Në rastin e një **rënie të pjesshme**, **OST** do të informoj **Rregullatorin** dhe të gjitha **palët** të cilat sipas mendimit të **OST** nevojitet të informohen, rreth **rënies së pjesshme** dhe se **OST** do të zbatoj procedurën e **startimit nga errësira** në atë pjesë të **sistemit**.

5.8.5 Procedura e rikthimit në punë

5.8.5.1 Procedura e nevojshme për rikthimin në punë pas një **rënie totale** ose një **rënie të pjesshme** njihet si procedura e **startimit nga errësira**, objektivi kryesor i së cilës është rikthimi i **sistemit** si një njësi e plotë e integruar sa më shpejtë që të jetë e mundur. Procedura për **rënie e pjesshme** është e njëjtë si për **rënie totale**, vetëm se aplikohet vetëm për një pjesë të **sistemit**. Është e rëndësishme të merret parasysh fakti se një **rënie e pjesshme** mund të ketë ndikimin në pjesët e tjera të **sistemit** të cilat nuk janë në operim.

5.8.5.2 Rivënia në punë pas një **rënie totale** ose një **rënie të pjesshme** është komplekse dhe deri në një farë mase është procedurë e papërcaktuar dhe si rezultat ky seksion dhe plani

i detajuar i rikthimit të **sistemit energjetik** duhet të jetë fleksibil sa duhet për të përshkruar gjithë serinë e karakteristikave të **njesisë gjeneruese** dhe të **sistemit** dhe mundësitë operative. Kjo parandalon përcaktimin e renditjes koncize - kronologjike.

5.8.6 Proceset kyçe

Në të gjitha fazat e procesit, duhet të merren parasysh faktorët në vijim:

- a) Të sigurohet se ka **gjenerim** të mjaftueshëm për të plotësuar **kërkesën** në çdo fazë të shtimit të **ngarkesës**;
- b) Të sigurohet se ka në dispozicion pajisje të mjaftueshme që reagojnë ndaj frekuencës;
- c) Rregullimi i tensionit të **sistemit** brenda kufijve të operimit;
- d) Nevojën e balancimit për rivendosjen e **ngarkesës** sa më shpejtë që të jetë e mundur kundrejt nevojës për të pasur një **sistem** relativisht të sigurtë.

5.8.7 Hapat kyç

5.8.7.1 Hapat kyç për rivënien në punë/rikthimin e **Sistemit Energjetik** janë si më poshtë:

- a) Zbulimi i rënies, konfirmimi se ka ndodhur një **rënie totale**;
- b) Përgatitja e mënyrave të rikthimit;
- c) Krijimi i **ishujve energjetik** stabil;
- d) Ri-sinkronizimi i **ishujve** energjetik që eventualisht formojnë një **sistem** të integruar;
- e) Rikthimi total i **ngarkesës**.

5.8.7.2 Rikthimi i **Sistemit energjetik** duke përdorur **startimin nga errësira** duhet të planifikohet dhe të ekzekutohet në mënyrë të tillë që njësitë gjeneruese kryesore (termo **centralet elektrike**) të furnizohen brenda maksimum prej dy orësh dhe e gjithë kërkesa brenda në maksimum prej 24 orësh.

5.8.8 Plani i rikthimit të sistemit energjetik

5.8.8.1 Në rastin e një defekti të madh në **sistemin energjetik**, rikthimi mund të ekzekutohet duke përdorur furnizimin me tension nga një ose më tepër **sisteme** fqinje, ose nëpërmjet **startimit nga errësira**.

5.8.8.2 Procedura për rikthimin e **Sistemit energjetik** do të jetë ajo e specifikuar nga **OST** në planin e tij të rikthimit të **Sistemit Energjetik** e azhurnuar herë pas here. **Përdoruesit** do t'i përmbahen udhëzimeve të **OST** gjatë situatave të **rënies totale** ose **rënieve të pjesshme** dhe nëse ato janë në konflikt me gjithë strategjinë e përgjithshme dhe bashkëpunimin me **OST**-të e vendeve të tjera do të jetë vetëm përgjegjësia e **OST**. Plani do të përmbajë minimum si më poshtë:

- a) Një listë të detajuar të numrave emergjent të telefonit;
- b) Një listë kontrolli të masave të menjëhershme që duhet të ndërmerren.

5.8.9 Konkluzionet e rikthimit të sistemit energjetik

Konkluzionet e situatës së **rënies totale** ose të **pjesshme** dhe koha e rikthimit të **sistemit** në operim normal do të përcaktohen nga **OST** i cili do të deklarojë për të gjitha **palët**, që sipas mendimit të **OST**, nevojitet të informohen se **sistemi** është rikthyer në funksionim normal duke përfshirë implementimin e procedurave të balancimit.

5.8.10 Raportimi pas rënies totale ose të pjesshme

Në rastin e një **rënie totale** apo të **pjesshme** të **Sistemit energjetik** të Kosovës, **OST** do të shkruajë një raport pas **ndodhisë** për **Rregullatorin**, siç përcaktohet nga **kodi i ndërlidhjes operative dhe furnizimit me informacione për ndodhitë**.

5.8.11 Testimi i startimit nga errësira

Testimet e përgjithshme të **startimit nga errësira** nuk janë as të zbatueshme dhe as të mundshme por testimet e pjesshme në ato kushte, që janë sa më pranë të jetë e mundur me ato të parashikuara në praktikë, duhet të kryhen në baza të rregullta. Për **Sistemin Energjetik** të Kosovës këto testime domosdo duhet të kufizohen në fushën e veprimit dhe rekomandohet që të kryhen testime më të detajuara në bashkëpunim me **OST**-të relevante fqinje. Të gjitha testimet duhet të përfshijnë testimet e stabilimenteve të nënstacioneve dhe komunikimin dhe kontrollin sipas paragrafit 5.8.12.

5.8.12 Komunikimet e startimit nga errësira dhe kontrolli

5.8.12.1 Komunikimet dhe kontrolli janë themelore për rikthimin e **Sistemit energjetik** pas një **rënie totale**. Është thelbësore që të gjitha pajisjet vitale duke përfshirë furnizimin nga palët e treta do të vazhdojnë të funksionojnë për të paktën 24 orë pas **rënies totale** të **Sistemit energjetik**. Disa pajisje kyçe që ndodhen në vende të largëta do të duhet të kenë periudha më të gjata operimi pas rënies së **Sistemit energjetik**.

5.8.12.2 Si pjesë e testimit të rregullt të **startimit nga errësira** sistemet e komunikimit dhe kontrollit duhet gjithashtu të testohen të paktën çdo dy vjet me simulimin e dështimit të furnizimit me energji.

5.8.13 Trajnimi i personelit dhe familjarizimi

Personeli i përfshirë në procesin e rikthimit të **sistemit** duhet të trajnohet periodikisht mbi funksionet dhe konceptet dhe implementimin praktik të mënyrave të rikthimit. Simulatorët e **Sistemit energjetik** dhe ushtrimet në kompjuter duhet të përdoren gjatë trajnimit. Është përgjegjësi e **OST** që të trajnojë stafin e tij të përfshirë në rikthimin e **sistemit** në gjendjen e mëparshme dhe është përgjegjësi e **përdoruesve** gjegjësisht që të sigurojnë se operatorët e tyre janë të trajnuar mirë dhe të aftë për të ekzekutuar udhëzimet e **OST** sipas procedurës së rikthimit në gjendjen e mëparshme.

5.8.14 Konfidencialiteti

Të gjithë **përdoruesit** duhet ta konsiderojnë si konfidencial të gjithë informacionin që iu komunikohet atyre nga **OST** sipas procedurës së rikthimit në gjendjen e mëparshme të **sistemit**.

5.9 Humbja e qendrës së kontrollit

Qendra e kontrollit të **OST** luan një rol thelbësor për t'i siguruar **OST** aftësinë që të operojë **Sistemin Energjetik** në nivelet e kërkuara të sigurisë dhe besueshmërisë. Në rastet kur qendra e kontrollit të **OST** bëhet e papërdorshme për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme atëherë duhet të vihet në dispozicion një **plan krize i qendrës së kontrollit** për transferimin e qetë të funksioneve të qendrës së kontrollit që do të lehtësonte operimin e vazhdueshëm të qetë dhe të sigurt të tërë **Sistemit energjetik** të Kosovës.

5.9.1 Plani i krizës së qendrës së kontrollit

Plani i krizës së qendrës së kontrollit do të përgatitet nga **OST** dhe do të përfshijë minimum si më poshtë:

- a) Detajet e metodave të komunikimit emergjent për të dakorduar transferimin e funksioneve të qendrës së kontrollit;
- b) Një listë kontrolluese të masave që do të ndërmerren dhe nga kush do të ndërmerren;
- c) Aranzhimet e detajuara për transferimin e funksioneve të kontrollit.

5.9.2 Testimi i planit të krizës së qendrës së kontrollit

Plani i krizës së qendrës së kontrollit duhet të testohet plotësisht ose pjesërisht në baza të rregullta të paktën një herë në dy vjet për të siguruar që ai është i zbatueshëm dhe se informacioni i nevojshëm është në dispozicion në lokacionet korrekte dhe personeli është plotësisht i trajnuar për ta kryer atë.

5.10 Procedurat e incidenteve të përbashkëta të sistemit

Një **incident i përbashkët i sistemit** është një **ndodhi** në **sistemin** e një **pale** që sipas mendimit të **OST** ka pasur ose mund të ketë një ndikim serioz dhe/ose të përhapur gjerësisht në **sistemin** e një **pale** tjetër.

5.10.1 Numrat e kontaktit

Çdo **përdorues** do të shkëmbejë në formë të shkruar numrat e telefonit me **OST**³ dhe ofruesin e shërbimit të **sistemit** relevant me të cilin ose nëpërmjet të cilit përfaqësuesit e menaxhmentit, të cilët janë plotësisht të autorizuar të marrin vendime detyruese në emër të organizatave të tyre mund të kontaktohen 24 orë në ditë kur ka një incident të përbashkët të **sistemit**. Për **përdoruesit** e rinj numrat e telefonit do të jepen kur të nënshkruhet **marrëveshja e kyçjes**. Numrat e dhënë duhet të azhurnohen në formë të shkruar sa herë qëndryshon informacioni që ato përmbajnë.

5.10.2 Paraqitja e një ndodhie

Kur paraqitet një **ndodhi** (ngjarje) duhet të ndërmerren masat e mëposhtme:

- a) Nëse është në **sistemin** e një **përdoruesi**, ai **përdorues** do njoftojë **OST**-në i cili nga ana tjetër do të njoftojë çdo **palë** tjetër që është ose ishte dëmtuar ose mund të dëmtohet;
- b) Nëse është në **sistemin** e **OST** ose në **sistemin** e një **pale** të ndërlidhur dhe **OST** është informuar nga **pala** e ndërlidhur, atëherë **OST** do të informojë **palët** të cilat janë dëmtuar ose mund të dëmtohen.
- c) Një njoftim do t'i dërgohet **Rregullatorit** nga ana e **OST**.

³ **OST** gjithashtu do të shkëmbejë numrat me **OST**-të e tjera sipas kërkesave të **marrëveshjeve interkonektive**.

5.11 Veprimet që pasojnë njoftimit të ndodhive

- 5.11.1 Pas njoftimit të një **ndodhie** në përputhje me paragrafin 5.10.2 dhe marrjes së informacionit shtesë të kërkuar në përputhje me këtë paragraf, **OSTT** do të përcaktojë nëse **ndodhia** është një incident i përbashkët i **sistemit** apo jo dhe nëse është kështu, **OST** mund të themeloj një **komision të incidenteve të përbashkëta të sistemit** për të mbikëqyrur incidentin dhe për të trajtuar të gjitha pyetjet në lidhje me të.
- 5.11.2 **OST**, sa më shpejt që të jetë e mundur, do të njoftojë të gjitha **palët** rreth themelimit të **komisionit të incidenteve të përbashkëta të sistemit** dhe numrave të telefonit të saj nëse janë të ndryshme nga ato të dhëna më herët sipas paragrafit 5.10.1.
- 5.11.3 Sapo të jetë themeluar **komisioni i incidenteve të përbashkëta të sistemit** i tërë komunikimi mes përfaqësuesve të lartë menaxherial të **palëve** relevante për sa i përket incidentit të përbashkët të **sistemit** do të bëhet nëpërmjet **komisionit të incidenteve të përbashkëta të sistemit**.

6 Kodi i rregullimit të ngarkesës

6.1 Parathënie

6.1.1 **Kodi i rregullimit të ngarkesës** trajton masat që duhet të ndërmerren nga **OSTT** në lidhje me **përdoruesit e ngarkesës** të kyçur drejtpërdrejtë në **Sistemin e Transmisionit** për të lejuar reduktimet e ngarkesës në rastet kur disponojmë me gjenerim të pamjaftueshëm për të plotësuar **kërkesën** totale.

6.1.2 **Kodi i rregullimit të ngarkesës** gjithashtu ofron masat për rregullimin e ngarkesës që i mundëson **OST** të menaxhojë **sistemin** total në rastet e prishjeve dhe/ose problemeve të operimit të tilla si frekuenca e **sistemit**, tensioni, ose mbingarkesa në ndonjë pjesë të **Sistemit Energjetik**.

6.1.3 Metodatat për reduktimin e **ngarkesës** të mbuluara nga **kodi i rregullimit të ngarkesës** përfshijnë:

- a) Menaxhimin e ngarkesës duke përdorur ngarkesa me mundësi të shkyçjes;
- b) Reduktimin urgjent të ngarkesës;
- c) Shkyçjen automatike të ngarkesës për shkak të nënfrekuencës;
- d) Shkyçjen manuale të ngarkesës në baza rotacioni;

6.1.4 Lloji i **rregullimit të ngarkesës** i përdorur nga **OST** në çdo rast të veçantë do të varet nga periudha e kohës prej momentit kur **OST** vlerëson për nevojën e implementimit të **rregullimit të ngarkesës** dhe kohës në të cilën ky rregullim duhet të implementohet. Megjithatë në të gjitha rastet, **OST** do të vendosë reduktimin e nevojshëm total të ngarkesës.

6.1.5 Procedura e përcaktuar në këtë seksion do të përfshijë **sistemin** e njoftimeve paralajmëruese që duhet të lëshohen nga **OST**.

6.1.6 **Kodi i rregullimit të ngarkesës** duhet të lexohet së bashku me **kodin e planifikimit të rasteve të paparashikuara**.

6.1.7 **Rregullimi i ngarkesës** nuk do të detyrohet aq sa të jetë e mundur për **konsumatorët** prioritar të tillë si ofruesit kryesor të shërbimeve të infrastrukturës, spitalet etj dhe do të zbatohet me këto përjashtime.

6.1.8 Kurdo që është e mundur, **rregullimi i ngarkesës** do të ushtrohet në mënyrë të barabartë për çdo **OSSH** dhe konsumator që është i kyçur drejtpërdrejtë me **Sistemin e Transmisionit**.

6.2 Objektivi

6.2.1 Objektivi i përgjithshëm i këtij seksioni është kërkesa e ofrimit të lehtësivetë mundshme që **OST** të arrij reduktimin e **ngarkesës** në mënyrë që të shmangë ose të zbusë problemet e operimit të tërë **Sistemit të Transmisionit** ose të një pjese të tij. Ky **rregullim i ngarkesës** do të bëhet në mënyrë të tillë që të mos krijojë preferenca në mënyrë të padrejtë për ndonjë grup **OSSH**-ës ose **konsumatorësh të ngarkesës** të kyçur drejtpërdrejtë në **Sistemin e Transmisionit**.

6.2.2 Objektivi tjetër është gjithashtu për të siguruar se **OST** do të njoftohet rreth masave të **rregullimit të ngarkesës** të ndërmarra nga **OSSH**-të ose **përdoruesit**, që janë të ndryshme nga udhëzimet e **OST**.

6.3 Fushëveprimi

6.3.1 Ky seksion aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **OSSH**-të;
- c) **Konsumatorët e ngarkesës** të kyçur drejtpërdrejtë në 110 kV ose më lartë.

Duhet të theksohet se ky kod nuk zbatohet direkt për **furnizuesit**, sepse implementimi i **rregullimit të ngarkesës** në lidhje me konsumatorët e tyre nuk zbatohet nga ata. Megjithatë konsumatorët e tyre mund të ndikohen nga **rregullimi i ngarkesës**. Ky do të implementohet nga **OST** aty ku konsumatori është i lidhur drejtpërdrejtë me **Sistemin e transmisionit** dhe nga **OSSH** për konsumatorë të tjerë. Aranzhimet e tyre kontraktuale duhet ta pasqyrojnë këtë.

6.4 Menaxhimi i ngarkesës dhe ngarkesat me mundësi të shkyçjes

Ngarkesat me mundësi të shkyçjes janë **konsumatorët e ngarkesës** që normalisht kanë një **ngarkesë** prej të paktën 1 MW të cilët janë pajtuar të lejojnë përdorimin e ngarkesës së tyre për menaxhimin e ngarkesës.

6.4.1 Kushtet për marrëveshje të shërbimeve ndihmëse

Konsumatorët e ngarkesës mund ta vënë ngarkesën e tyre në disponim, sipas kushteve të një **marrëveshjeje të shërbimeve ndihmëse**, për të siguruar përgjigjen ose rezervën e rregullimit të frekuencës. Marrëveshja do të deklarojë sasinë e **ngarkesës** në disponim për t'u shkyçur, periudhën e kohës për të cilën **ngarkesa** mund të reduktohet dhe kohëzgjatjen e njoftimit që do të jepet.

6.4.2 Marrëveshje vullnetare me një përdorues të ngarkesës

6.4.2.1 Nëse një **konsumator i ngarkesës** i kyçur në tensionin 110 kV dhe më lartë dëshiron t'i ofrojë **OST** mundësinë e menaxhimit të ngarkesës së **konsumatorit të ngarkesës** për qëllime emergjente të **rregullimit të ngarkesës**, ai do ta njoftojë **OST** në përputhje me **kodin e rregullimit të ngarkesës**. Ky do të jetë një shërbim në baza vullnetare për të cilin nuk do të ketë pagesë.

6.4.2.2 Deklarata do t'i jepet **OST** në formë të shkruar në fund të Dhjetorit të çdo viti. Kjo deklaratë do të konfirmojë se **konsumatori i ngarkesës** për vitin pasues do të përmbushë udhëzimet e **OST** në lidhje me menaxhimin e ngarkesës së **konsumatorit të ngarkesës**, nëse ato udhëzime janë brenda parametrave të përcaktuara në njoftim. Viti fillon me 1 Janar.

6.4.2.3 Deklarata do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) Sasinë e reduktimit të **ngarkesës** të vënë në disponim;
- b) Njoftimin që kërkohet t'i jepet **konsumatorit të ngarkesës** nga ana e **OST**-së;
- c) Sa shpesh mund të përdoret, numrin e rasteve, totalin e kohës, ose të dyja së bashku;
- d) Kohëzgjatjen në të cilën mund të përdoret reduktimi i ngarkesës në çdo rast;
- e) Çdo situatë në të cilën menaxhimi i ngarkesës së specifikuar më lart mund të vihet në disponim sipas dakordimit.

6.4.3 Marrëveshja vullnetare me një furnizues

6.4.3.1 Nëse një **furnizues** dëshiron t'i ofrojë **OST** mundësinë e përdorimit të menaxhimit të ngarkesës së **konsumatorit të ngarkesës** për qëllime emergjente të **rregullimit të**

ngarkesës, do ta njoftojë **OST** në përputhje me këtë **kod të rregullimit të ngarkesës**. Ky do të jetë një shërbim vullnetar për të cilin nuk do të paguhet.

6.4.3.2 Deklarata do t'i jepet **OST** në formë të shkruar në fund të Dhjetorit të çdo viti. Kjo deklaratë do të konfirmoj që **furnizuesi** për vitin pasuses do të përmbushë udhëzimet e **OST** në lidhje me menaxhimin e ngarkesës së **konsumatorit të ngarkesës**, nëse ato udhëzime janë brenda parametrave të përcaktuara në njoftim. Viti fillon me 1 Janar.

6.4.3.3 Deklarata do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) Sasinë e reduktimit të **ngarkesës** së vënë në disponim;
- b) Njoftimin që kërkohet t'i jepet **furnizuesit** nga ana e **OST**;
- c) Sa shpesh mund të përdoret, numrin e rasteve, ose totalin e kohës, ose të dyja së bashku;
- d) Kohëzgjatjen në të cilën mund të përdoret reduktimi i ngarkesës në çdo rast;
- e) Çdo situatë në të cilën menaxhimi i ngarkesës së specifikuar më lartë mund të vihet në disponim sipas akordimit.

6.4.4 Njoftimet paralajmëruese

Të gjitha shkyçjet e ngarkesës sipas paragrafit 6.4 do të kryhen si pjesë e marrëveshjes ose deklaratës dhe do të dakordohen paraprakisht. Si rezultat nuk kërkohet dhënia e njoftimeve formale paralajmëruese.

6.5 Aranzhimet e reduktimit manual emergjent të ngarkesës

6.5.1 Rastet e reduktimit manual emergjent

6.5.1.1 Reduktimi manual emergjent i ngarkesës përdoret kur humbja e **gjenerimit** ose mospërputhja e prodhimit dhe **ngarkesës** është si kërkesë operationale për reduktimin e ngarkesës me një njoftim të shkurtër (ose pa njoftim). Në këto rrethana **OST** duhet të mirëmbajë margjinën operuese por në raste tjera mund të merret me problemet e operimit të tillë si nivelet e papranueshme të tensionit dhe mbingarkesat.

6.5.1.2 Çdo **OSSH** do të aranzhojë që të ketë në dispozicion planet për reduktimin manual të ngarkesës brenda **sistemit të shpërndarjes** përkatës. Këto plane duhet t'i komunikohen **OST**-së.

6.5.1.3 Aranzhimet mund të vihen në funksionim pavarësisht nga frekuenca e **sistemit** dhe do të implementohen sipas udhëzimeve të **OST** dhe mund të kërkojnë reduktim progresiv të ngarkesës në afatet kohore të paracaktuara.

6.5.2 Aranzhimet

6.5.2.1 **OST** do të bëjë aranzhime të tilla të nevojshme me **OSSH**-të në mënyrë që të mund të arrihet një reduktim i ngarkesës në tri faza. Aranzhimet për secilën fazë detajohen më poshtë dhe do të aplikohen për **sistemin** total. Në disa raste mund të jetë e nevojshme të aplikohet reduktimi i ngarkesës vetëm për disa pjesë të sistemit.

6.5.2.2 **OST** do të pajtohet me aranzhimet e **OSSH**-ve brenda planeve përkatëse të **Sistemit të Shpërndarjes** të tyre për të reduktuar ngarkesën në mënyrë të kontrolluar. Reduktimi i ngarkesës do të arrihet duke reduktuar tensionin dhe/ose duke shkyçur ngarkesën.

6.5.3 Aranzhimet e reduktimit të ngarkesës

6.5.3.1 **OST** do të aranzhojë me **OSSH**-të që ato të kenë në dispozicion tri fazat e reduktimit të ngarkesës siç parashtrohet në seksionin 6.5.4.

6.5.3.2 Për sa i përket shkyçjeve të ngarkesës, **OSSH**-të do të jenë përgjegjëse për aranzhimet e detajuara dhe për grupimin e ngarkesës por duhet të marrin parasysh kategoritë prioritare të konsumatorëve. Orari përfundimtar do të dakordohet me **Rregullatorin**.

6.5.3.3 Reduktimi emergjent i ngarkesës do të kryhet vetëm atëherë kur ka probleme serioze dhe **OSSH** duhet ta kryejë shkyçjen e ngarkesës në mënyrë të tillë që të minimizojë efektshmërinë e skemës së **reduktimit nga nënfrekuenca**.

6.5.4 Fazat e reduktimit të ngarkesës

Tri fazat e reduktimit të ngarkesës që do të aplikohen për **sistemin total** janë detajuar në paragrafët e mëposhtëm.

6.5.5 Faza 1

Faza 1 do të kërkojë një tension prej 3% – sipas Politikës P3-M1 të Doracakut të Operimit të **ENTSO-E** që do të aplikohet për të gjithë konsumatorët në **sistemin total** ose në zonën e prekur si të jetë e zbatueshme.

6.5.6 Faza 2

Faza 2 do të kërkojë një tension prej 5% – sipas Politikës P3-M1 të Doracakut të Operimit të **ENTSO-E** – që do të aplikohet për të gjithë konsumatorët në **sistemin total** ose në zonën e prekur si të jetë e zbatueshme.

6.5.7 Faza 3

Faza 3 normalisht do të aplikohet pas fazave 1 dhe 2 dhe do të kërkojë shkyçjen e ngarkesës. Sasia e ngarkesës që duhet të shkyçet do të udhëzohet nga **OST**.

6.5.8 Nëse dështon implementimi i dispozitave 6.5.5, 6.5.6 dhe 6.5.7 atëherë duhet të zbatohet dispozita 2.6.1.7 e **Kodit të Balancit**.

6.6 Aplikimi

6.6.1.1 Në të gjitha rastet, reduktimi i ngarkesës do të aplikohet sa më parë që të jetë praktikisht e mundur pas marrjes së një udhëzimi të dhënë në mënyrë korrekte nga ana e **OST**. Udhëzimi nga ana e **OST** mund të kërkojë që reduktimi i ngarkesës të aplikohet nga **OSSH**-ja në të gjithë sistemin e tij ose në disa pjesë të tij.

6.6.1.2 Para udhëzimit të reduktimit të ngarkesës mund të jetë dhënë një njoftim paralajmërues nga ana e **OST** sipas paragrafit 6.8 të **kodit të rregullimit të ngarkesës**. Megjithatë në kushtet emergjente mund të mos ketë kohë të mjaftueshme për dhënien e këtij njoftimi. Nëse është dhënë një njoftim paralajmërues për reduktimin e ngarkesës, secila **OSSH** do t'i bindet plotësisht udhëzimeve të dhëna nga **OST** për sa i përket sasisë së reduktimit të ngarkesës që duhet të arrihet dhe **OSSH** do të pajtohet pa vonesë. Reduktimi i ngarkesës duhet të arrihet sa më shpejtë që të jetë e mundur por jo më vonë se pesë minuta nga momenti i dhënies së udhëzimit nga ana e **OST**.

6.7 Rivendosja e ngarkesës

6.7.1.1 Sapo të jetë aplikuar një reduktim i ngarkesës nga **OSSH** pas udhëzimit të **OST**, aq sa të jetë e mundur, **OSSH** duhet të sigurojë që ngarkesa dhe/ose tensioni do të mbetet i reduktuar me sasinë e kërkuar. Ky reduktim i kërkuar i ngarkesës duhet të mbahet derisa **OST** ta udhëzojë **OSSH**-në që të aplikojë një reduktim të mëtejshëm të ngarkesës në përputhje me këtë paragraf ose ta heqë reduktimin e ngarkesës dhe/ose tensionit dhe të rivendosë vlerën normale të ngarkesës dhe/ose tensionit.

6.7.1.2 Çdo **OSSH** do t'i përmbahet udhëzimeve të **OST** në lidhje me reduktimin e ngarkesës sipas paragrafit 6.5 pa vonesë dhe rivendosja e udhëzuar e ngarkesës do të arrihet pa vonesa të tepruara.

6.8 Njoftimet paralajmëruese

6.8.1 Njoftimet e përgjithshme

6.8.1.1 Brenda aranzhimeve të reduktimit të ngarkesës do të jetë një sistem i njoftimeve paralajmëruese që do të japë njoftim, kurdo që është praktikisht e mundur, rreth implementimit të mundshëm. Aty ku ka mungesë të kapacitetit gjenerues ose arsye të tjera për aplikimin e **rregullimit të ngarkesës, OST** do të lajmërojë **OSSH**-të me anë të një njoftimi paralajmërues të **rregullimit të ngarkesës**.

6.8.1.2 Në rastet e masave emergjente të pranuar nga **OST** kur nuk ka kohë të mjaftueshme për të dhënë një njoftim paralajmërues, kërkesat e këtij paragrafi nuk do të aplikohen.

6.8.2 Forma e njoftimit paralajmërues të rregullimit të ngarkesës

6.8.2.1 Në rastet kur kërkohet, sistemi i mëposhtëm i paralajmërimeve do të përshtatet nga **OST** në mënyrë që t'i lejojë **OSSH**-së të ndërmarrë masat e nevojshme përgatitore në mënyrë që të kryej udhëzimet e pritura nga **OST**.

6.8.2.2 Të gjitha paralajmërimet do të përmbajnë si minimum informacionet e mëposhtme:

- a) Sasinë e reduktimit të ngarkesës dhe/ose tensionit që do të arrihet;
- b) Kohën e pritur të implementimit;
- c) Kohën e pritur të rivendosjes;

6.8.3 Paralajmërimi i verdhë

6.8.3.1 Në rastet e fazës 1 të reduktimit të ngarkesës në sistem, **OST** do të lëshojë një njoftim paralajmërues me ngjyrë të verdhë. Ky do të përmbajë informacionin e detajuar më lartë dhe zonën të cilën e mbulon paralajmërimi nëse ai nuk aplikohet për **sistemin total**.

6.8.3.2 **Palët** e mëposhtme do të marrin një kopje të njoftimit paralajmërues me ngjyrë të verdhë kur ai të lëshohet:

- a) **OSSH**-të e ndikuara prej tij;
- b) **Rregullatori**

6.8.4 Njoftimi paralajmërues i portokalltë

- 6.8.4.1 Në rastet e fazës 2 të reduktimit të ngarkesës në sistem, **OST** do të lëshojë një njoftim paralajmërues me ngjyrë të portokalltë. Ky do të përmbajë informacionin e detajuar më lartë dhe zonën të cilën e mbulon paralajmërimi nëse ai nuk aplikohet për **sistemin total**.
- 6.8.4.2 **Palët** e mëposhtme do të marrin një kopje të njoftimit paralajmërues me ngjyrë të portokalltë kur ai të lëshohet:
- a) **OSSH-të** e ndikuara prej tij;
 - b) **Rregullatori**.

6.8.5 Njoftimi paralajmërues i kuq

- 6.8.5.1 Në rastet e fazës 3 të reduktimit të ngarkesës në sistem, **OST** do të lëshojë një njoftim paralajmërues me ngjyrë të kuqe. Ky do të aplikohet për **sistemin total** dhe do të përmbajë informacionin e detajuar më lartë.
- 6.8.5.2 Meqë një njoftim paralajmërues me ngjyrë të kuqe aplikohet për **sistemin total** dhe mund të përfshijë shkyçjen e ngarkesës, ai do të lëshohet për të gjithë **OSSH-të**, të gjithë **gjeneruesit**, të gjithë **furnizuesit** dhe **Rregullatorin**.

6.8.6 Anulimi i njoftimeve paralajmëruese

Të gjitha njoftimet paralajmëruese do të mbeten në fuqi derisa të anulohen në mënyrë specifike nga **OST**.

6.9 Raportimi pas ndodhisë

Në rastin kur **OST**-ës i është dashur të lëshojë një njoftim paralajmërues dhe/ose të udhëzojë reduktimin manual të ngarkesës, atëherë **OST** -ës do t'i kërkohet, sa më shpejt që të jetë e mundur pas **ndodhisë**, që në çdo rast brenda dy ditësh të përgatisë një raport të shkurtër të incidentit për t'ia paraqitur **Rregullatorit**.

6.10 Reduktimi nga nënfrekuenca

- 6.10.1.1 Skema e **reduktimit** nga nënfrekuenca është modeluar për ta mbrojtur **sistemin** e interkoneksionit në rastet kur frekuenca e **sistemit** total ose e një pjese të izoluar të **sistemit** total bie në 49.00 Hz. Kjo mund të ndodhë për shkak të një mospërputhje të rëndë të prodhimit/ngarkesës të shkaktuar nga një ose disa ndodhi të rënda dhe të

papritura apo të papërballueshme. Në këto rrethana skema e **reduktimit nga nënfrekuenca** do të funksionojë për të çkyçur ngarkesën në blloqe.

6.10.1.2 Përgatitja e skemës së reduktimit nga nënfrekuenca dhe implementimi i saj duhet të koordinohen me **OST**-të fqinje dhe **OST**-të e tjera regjionale.

6.11 Operimi

Detajet e skemës së **mbrojtjes nga nënfrekuenca** janë trajtuar plotësisht në **kodin e planifikimit të rasteve të paparashikuara**, por në thelb 55% e ngarkesës totale shkyçet në katër faza nga 49.00 Hz në 48.00Hz sipas tabelës⁴ së mëposhtme:

	Faza 1 (49.0 Hz)	Faza 2 (48.8 Hz)	Faza3 (48.4 Hz)	Faza 4 (48.0 Hz)
Reduktimi i ngarkesës në një fazë të vetme (%)	10	15	15	15
Reduktimi total i ngarkesës (%)	10	25	40	55

6.12 Reduktimi i ngarkesës me rotacion

6.12.1 Rastet e përgjithshme të reduktimit të ngarkesës

6.12.1.1 Procedura e shkyçjes manuale e planifikuar do të aplikohet kur ka mungesë të **prodhimit** ose probleme në **Sistemin e Transmisionit** që kërkojnë reduktimin e ngarkesës nëpërmjet shkyçjes mund të parashikohen qartë për një periudhë të zgjatur. Në rrethana të tilla rotacioni i shkyçjes sipas një procedure të reduktimit të ngarkesës me rotacion mund të kërkohet për të siguruar trajtimin e barabartë, aq sa të jetë praktikisht e mundur, për të gjithë konsumatorët. Konsumatorët do të shkyçen në baza rotacioni për periudha deri në katër orë ku një periudhë do të fillojë në mesnatë.

6.12.1.2 Reduktimi i ngarkesës nëpërmjet shkyçjes do të implementohet në përputhje me planin e reduktimit të ngarkesës me rotacion.

⁴ Këto vlera janë nga marrëveshja mes OST-ve EJJL. Kjo marrëveshje gjithashtu specifikon se pas Fazës 2 secili sistem energjetik duhet të vendosë në mënyrë të pavarur për shkyçjen nga interkonekcioni regjional.

6.12.1.3 **OST** dhe **OSSH**-të do të dakordohen çdo vit rreth numrit të grupeve të kërkuara dhe lehtësimin e pritur të **ngarkesës** nga secili prej këtyre grupeve. Ky informacion do të përdoret nga **OSSH**-të në përgatitjen e planit të tyre të **reduktimit të ngarkesës me rotacion**.

6.12.2 **Plani i reduktimit të ngarkesës me rotacion**

6.12.2.1 **OSSH**-ve do t'iu kërkohej të përgatisin një plan të reduktimit të ngarkesës me rotacion. Ky plan do të rishikohet çdo vit dhe do të azhurnohet sipas kërkesave. Do të përmbajë informacionet e detajuara si në paragrafin e mëposhtëm.

6.12.2.2 Plani i **reduktimit të ngarkesës me rotacion** do të përmbajë minimum informacionet si më poshtë:

- a) Grupin për të cilin është caktuar secila pikë e ngarkesës që do të reduktohet;
- b) Reduktimi i pritur i ngarkesës në secilën pikë të reduktimit të ngarkesës;
- c) Detajet për konsumatorët prioritar në secilin vend ndodhje të ngarkesës;
- d) Aranzhimet e kyçjeve dhe shkyçjeve në secilën pikë të reduktimit të ngarkesës.

6.12.3 **Njoftimi paralajmërues i reduktimit të ngarkesës me rotacion**

Para implementimit të **reduktimit të ngarkesës me rotacion**, ose sa më shpejtë që të jetë e mundur pasi ai është implementuar, **OST** do t'i dërgojë një njoftim paralajmërues **OSSH**-ve, gjithë **gjeneruesve**, gjithë **furnizuesve** dhe **Rregullatorit**. Ky njoftim do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) Zonën në të cilën do të aplikohet **reduktimi i ngarkesës me rotacion**;
- b) Sasinë e reduktimit të ngarkesës të kërkuar në secilën periudhë katër orëshe;
- c) Datën dhe orën e fillimit;
- d) Kohëzgjatjen e pritur.

6.12.4 **Aplikimi i reduktimit të ngarkesës me rotacion**

Kur **OST** përcakton se kërkohej të implementohet reduktimi i ngarkesës me rotacion, ai do të udhëzojë **OSSH**-të gjegjëse prekura që të fillojnë sipas njoftimit të mëparshëm ose udhëzimit verbal të **reduktimit të ngarkesës me rotacion**. Një udhëzim verbal do të

përforcohet, sa më parë që të jetë e mundur, me një njoftim paralajmërues të **reduktimit të ngarkesës me rotacion** sipas paragrafit 6.12.3.

6.12.5 Anulimi i reduktimit të ngarkesës me rotacion

Kur nuk ekziston më nevoja për **reduktim të ngarkesës me rotacion**, **OST** do të lëshojë një njoftim për anulimin e **reduktimit të ngarkesës me rotacion** dhe do të udhëzojë **OSSH**-të sipas rastit. Njoftimi i anulimit të **reduktimit të ngarkesës me rotacion** do të lëshohet për **OSSH**-të, gjithë **gjeneruesit**, gjithë **furnizuesit** dhe **Rregullatorin**.

6.12.6 Paralajmërimet e konsumatorëve

Reduktimi i ngarkesës me rotacion pas fillimit do të jetë një **ndodhi** e planifikuar dhe konsumatorët mund të informohen rreth kohës dhe kohëzgjatjes që pritet të ketë shkyçje të furnizimit të tyre. Përgjegjësia mbetet tek **OSSH**-të të cilat duhet të kenë aranzhime të cilat mund të aktivizohen si pjesë e planit të tyre të reduktimit të ngarkesës me rotacion. Këto plane mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm nga pikat e mëposhtme:

- a) Njoftimet në gazeta;
- b) Njoftimet në radio dhe në televizion;
- c) Njoftimet në dispozicion në zyrat e **OSSH**-ve;
- d) Informacionin në faqet e internetit të **OSSH**-ve dhe/ose të **OST**.

6.13 Kompensimi

Në përgjithësi nuk do të ketë kompensim të ndonjë pale për shkyçjet e planifikuara dhe të paplanifikuara, manuale dhe automatike të udhëzuara në mënyrë korrekte dhe të aplikuara në përputhje me **kodin e rregullimit të ngarkesës**, me përjashtim të rasteve sipas paragrafit 6.4.1 më lartë.

7 Kodi i identifikimit të stabilimentit dhe aparatit

7.1 Parathënie

Ky seksion përcakton përgjegjësitë dhe procedurat për identifikimin e **stabilimentit dhe aparaturave** që do të përdoret në të gjitha vendet duke përfshirë ato që kanë një kufi pronësie. Aplikohet për vendet e reja dhe vendet ekzistuese.

7.2 Objektivi

7.2.1 Objektivi i përgjithshëm i këtij seksioni është si më poshtë:

- a) Nevoja për të siguruar që të gjitha nënstacionet, **centralet elektrike** dhe **pikat e kyçjes** janë të identifikuara me emra të cilët nuk krijojnë keqinterpretim dhe shkurtesat e të cilave janë të veçanta (unike);
- b) Kërkesa që, pas nënshkrimit të **marrëveshjes së kyçjes (MK)**, të gjitha stabilimentet në nënstacione në kufijtë e pronësisë, të kenë një sistem identifikimi të **stabilimenteve dhe aparaturave** të miratuar nga **OST**. Si **OST** ashtu edhe **përdoruesi** relevant do të përdorin sistemin e përbashkët të identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturave** për të mundësuar funksionimin e sigurtë dhe efikas të **sistemit** dhe reduktimin e gabimit nga njeriu;
- c) Përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të aplikohen në kufijtë e pronësisë për regjistrimin e identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturave** të reja dhe ndryshimet e identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturave** ekzistuese.

7.2.2 Identifikimi i **Stabilimentit dhe Aparaturave** në një **pikë të kyçjes** do të përfshihet në skemën njëpolëshe të përgatitur për secilin vend që ka një kufi pronësie sipas **procedurës për kyçje në kodin e kyçjes**.

7.3 Fushëveprimi

Ky seksion aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **OSSH-të**;
- c) **Të gjithë gjeneruesit**;

- d) **Konsumatorët e ngarkesës** të kyçur drejtpërdrejtë me **Sistemin e Transmisionit**;

7.4 Procedura

7.4.1 Emrat dhe shkurtesat e vendeve

7.4.1.1 Është thelbësore, në interes të sigurisë dhe efikasitetit operativ, që emrat e të gjitha vendeve – nënstationeve, **centraleve elektrike** dhe **pikave të kyçjes** – të kyçura me **Sistemin e Transmisionit** ose që përbëjnë një pjesë të **Sistemit të Transmisionit** nuk mund të jenë objekt i keq-interpretimit dhe që të gjitha shkurtesat e këtyre vendeve duhet të jenë të veçanta (unike).

7.4.1.2 Detajet bazë të të gjitha vendeve 110 kV e më lart do të mbahen në një regjistër të bazës së të dhënave që do të mirëmbahet dhe azhurnohet nga **OST**.

7.4.1.3 Kur një **përdorues** ka për qëllim të lidhë një pikë të re me **Sistemin e Transmisionit**, atëherë emri për vendin e ri do të dakordohet me **OST** me rastin e parë që nuk do të çojë në ndonjë konfuzion. Sapo emri të jetë dakorduar **OST** do të japë një shkurtesë të veçantë (unike) për vendin.

7.4.2 Identifikimi i stabilimentit dhe aparaturave

Identifikimi i **stabilimentit dhe aparaturave** për të gjitha vendet do të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e procedurës relevante.

7.4.3 Aparaturat e reja

7.4.3.1 Kur një **përdorues** ka për qëllim të instalojë aparatura në një vend me kufinjë pronësie, identifikimi i propozuar i **stabilimentit dhe aparaturave** që do të aplikohet duhet t'i bëhet i ditur të gjitha palëve në atë vend.

7.4.3.2 Njoftimi do të bëhet në formë të shkruar për të gjitha **palët** relevante dhe do të përbëhet nga skema njëploëshe që inkorporon aparaturën e re të propozuar që do të instalohet dhe identifikimin e tij.

7.4.3.3 Njoftimi për **palët** relevante do të behët të paktën tetë muaj para instalimit të propozuar të aparaturës.

7.4.3.4 Marrësit e njoftimit do të përgjigjen me shkrim brenda një muaji nga marrja e njoftimit duke deklaruar nëse identifikimi i propozuar i **stabilimentit dhe aparaturave** është ose nuk është i pranueshëm dhe duke konfirmuar se ai nuk mund të ngatërrohet me

identifikimin ekzistues të **stabilimentit dhe aparaturave**. Nëse identifikimi nuk është i pranueshëm atëherë përgjigja me shkrim do të parashtrojë se çfarë do të ishte e pranueshme.

7.4.3.5 Në rastin kur nuk mund të arrihet një marrëveshje mes **OST** dhe **palëve** të tjera, **OST** duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, do të ketë të drejtën e përcaktimit të identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturave** që do të aplikohet në vend.

7.4.3.6 **Përdoruesve** pas kërkesës do t'u sigurohen detajet e identifikimit standard të sistemit të **stabilimentit dhe aparaturave** sipas **kodit të identifikimit të stabilimentit dhe aparaturave** në mënyrë që të ndihmohen në planifikimin e identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturave** në vendet e kufijve të pronësisë.

7.4.3.7 Sapo të jenë dakorduar, detajet e identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturave** do t'i jepen **OST** që t'i përfshijë në regjistrin e bazës së të dhënave.

7.4.3.8 **OST** dhe çdo **përdorues** do të jenë përgjegjës për parashikimin dhe vënien e etiketimeve të qarta që tregojnë identifikimin e **stabilimentit dhe aparaturave**.

7.4.4 Aparaturat ekzistuese

7.4.4.1 Çdo **palë** në vend duke përfshirë **OST** do t'i japë palës tjetër detajet e identifikimit të **stabilimentit dhe aparaturat** në vendet që kanë kufij pronësie.

7.4.4.2 **OST** dhe çdo **përdorues** do të jenë përgjegjës për parashikimin dhe vënien e etiketimeve të qarta që tregojnë identifikimin e **stabilimentit dhe aparaturat** e tyre në vendet që kanë një kufi pronësie.

7.4.5 Ndryshimet në aparaturat ekzistuese

7.4.5.1 Aty ku **OST** ose një **përdorues** kërkon ose dëshiron të ndryshojë identifikimin ekzistues të ndonjërit nga **stabilimentet dhe aparaturat** në ndonjë vend që ka kufij pronësie, do të aplikohen dispozitat e mësipërme me ndonjë ndryshim të nevojshëm për të pasqyruar që po bëhet vetëm një ndryshim.

7.4.5.2 Kur një **përdorues** e ndryshon identifikimin e **stabilimentit dhe aparaturave**, ai **përdorues** do të jetë përgjegjës për parashikimin dhe vënien e një etiketimi të qartë.

7.4.5.3 Aty ku **OST** e ndryshon identifikimin e **stabilimentit dhe aparaturave** të tij, **OST** do të jetë përgjegjës për parashikimin dhe vënien e një etiketimi të qartë.

7.5 Obligimi i përkujdesjes

- 7.5.1 Asnjë **palë** nuk do të këmbëngulë, apo lejojë instalimin e ndonjë **stabilimenti dhe aparature** në ndonjë vend që ka një emër të vendit apo një shkurtesë apo ndonjë numër ose nomenklaturë që mund të ketë keq-interpretim.
- 7.5.2 Asnjë **palë** në ndonjë vend me kufij pronësie nuk do të këmbëngulë apo lejojë instalimin e ndonjë **stabilimenti dhe aparature** në një vend i cili ka një identifikim që mund të ngatërrohet me atë të një **pale** tjetër dhe asnjë **palë** nuk do ta ndryshojë identifikimin pa marrë marrëveshjen me shkrim të **palëve** të tjera.
- 7.5.3 **OST** mund të vizitoj dhe verifikoj korrektësinë e etiketimit dhe në të njëjtën kohë rezervon të drejtën që të sigurohet në mënyrë periodike që etiketimi është korrekt. Megjithatë, gjatë gjithë kohës është përgjegjësi e **përdoruesve** që të sigurojnë korrektësinë e etiketimit të tyre.

8 Testimet e sistemit

8.1 Parathënie

- 8.1.1 Ky seksion përcakton përgjegjësitë dhe procedurat për aranzhimin dhe kryerjen e **testimeve të sistemit** të cilat kanë ose mund të kenë ndikim mbi të gjitha ose mbi një pjesë të **sistemit** total ose në **sistemet** e **OST**, të një **përdoruesi** apo një **pale** të ndërlidhur. Aty ku një **testim i sistemit** i propozuar nga një **përdorues** nuk do të ketë ndikim në **Sistemin e Transmisionit** atëherë ky lloj **testimi i sistemit** nuk është pjesë e këtij seksioni dhe si rezultat ky seksion nuk do të aplikohet për të. Një **testim i sistemit** i propozuar nga **OST** i cili do të ketë ndikim në **sistemin** e një **përdoruesi** gjithmonë do të jetë pjesë e këtij seksioni.

8.2 Objektivi

- 8.2.1 Objektivat e këtij seksioni janë që të sigurohet se ekzistojnë procedurat që lejojnë aranzhimet dhe kryerjen e **testimeve të sistemit** dhe aq sa të jetë praktikisht e mundur **testimet e sistemit** të:
- Mos kërcënojnë sigurinë e personelit dhe opinionit të gjerë;
 - Shkaktojnë rrezik minimal për sigurimin e furnizimit dhe integritetin e **stabilimentit dhe aparaturave**.
 - Mos dëmtojnë **OSTT**, **përdoruesit** dhe **palët** e ndërlidhura.

8.2.2 Ky seksion gjithashtu përcakton procedurat që aplikohen për kryerjen dhe raportimin e testeve të sistemit.

8.3 Fushëveprimi

Ky kod aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **Gjeneruesit** duke përfshirë **gjeneruesit me njësi gjeneruese** të kyçura në **sistemin e shpërndarjes**;
- c) **Stacionet gjeneruese të energjisë me erë** me kapacitet ≥ 10 MW;
- d) **OSSH-të** e kyçura me **Sistemin e Transmisionit**;
- e) **Konsumatorët e ngarkesës** të kyçur drejtpërdrejtë në **Sistemin e Transmisionit**.

8.4 Përkufizimi i testeve të sistemit

8.4.1 **Testimet e sistemit** janë testimet që përfshijnë simulimin e kushteve ose aplikimin e kontrolluar të kushteve të jashtëzakonshme, të pazakonta ose ekstreme mbi **sistemin** total ose ndonjë pjesë të **sistemit**.

8.4.2 **Testimet e sistemit** përfshijnë testimet e mëposhtme por nuk kufizohen me to:

- a) Efektet e harmonikëve;
- b) Refuzimin e ngarkesës për testimin e reagimit të frekuencës ku kërkohet përfshirja e **OSTT**.
- c) Stabilitetin dinamik;
- d) Testimet në lidhje me planet e **startimit nga errësira**

8.4.3 Përveç detajeve të dhëna në paragrafin 8.4.2 **testimet e sistemit** normalisht nuk përfshijnë testimet e komisionimit dhe rivënies në punë, testimet e kërkuara në mënyrë rutinore nga **OST** në mënyrë që të vlerësohet pajtueshmëria e **përdoruesve** me kërkesat e modelimit, operimit dhe kyçjes siç specifikohet në **Marrëveshjen e Kyçjes** dhe **Marrëveshjen e Shërbimeve Ndihmëse** të secilit **përdorues** ose testimet e tjera të vogla të tilla si testimi i mbrojtjes.

8.5 Procedura e testeve

- 8.5.1 Në rastet kur **OST** kërkon të kryej një testim që është brenda përkufizimit të mësipërm të **testimit të sistemit** atëherë **OST** jep një njoftim të paktën 14 ditë para testimit për palët të cilat do të ndikohen ose mund të ndikohen nga testimi. Në këtë njoftim **OST** do të japë informacion të mjaftueshëm në mënyrë që **palë** marrëse e njoftimit të mund të vlerësojë rreziqet për **sistemin** dhe stabilimentit të tij. Nëse, sipas mendimit të tyre, ekziston një rrezik serioz për **sistemin** apo stabilimentin e tij, **palët** mund të kërkojnë që **OST** ta shtyjë më vonë testimin. Në rastin kur palët nuk arrijnë të merren vesh, secila **palë** mund të thirret në procedurën e mosmarrëveshjes brenda **Kodit të Rrjetit**.
- 8.5.2 Kur një **palë** tjetër, e ndryshme nga **OST** kërkon të kryejë një testim që është brenda përkufizimit të një **testimi të sistemit** atëherë ajo palë do të informojë **OST** dhe do të aplikoj procedurën e ngjashme si në paragrafin 8.5.2.

8.6 Programi i testimit

- 8.6.1 Sapo të jetë miratuar dhe dakorduar **testimi i sistemit**, do të caktohet një panel i testimit, i cili do të paraqesë draft programin e testimit. Të gjitha palët e ndikuara do të kenë mundësinë ta komentojnë draft programin e testimit së paku shtatë ditë para datës së planifikuar të testimit. Sapo ky program të jetë dakorduar dhe programi final i testimit të jetë përgatitur dhe dërguar tek të gjitha palët e ndikuara, do të caktohet paneli i testimit.
- 8.6.2 Parimi i përgjithshëm i aplikuar për caktimin (shpërndarjen) e kostove mes palëve të përfshira në **testimet e sistemit**, është që kostot do të barten nga propozuesi i testimit.
- 8.6.3 Në rast mosmarrëveshje për caktimin e kostove, secila palë e përfshirë ka të drejtën të fillojë procedurën e mosmarrëveshjes (kontestet) që gjendet në **Dispozitat e përgjithshme të Kodit të Rrjetit**.

8.7 Implementimi i testimit të sistemit

- 8.7.1 Nëse në ditën e propozuar të **testimit të sistemit**, kushtet e funksionimit të **sistemit** janë të tilla që çdo palë e përfshirë dëshiron ta shtyjë ose ta anulojë fillimin apo vazhdimin e **testimit të sistemit**, ata menjëherë duhet të informojnë palët tjera rreth këtij vendimi dhe arsyeve për marrjen e tij. **OST** do të jetë përgjegjës për shtyrjen, anulimin apo vazhdimin e **testimit të sistemit** sipas rastit. Në rastin kur testimi shtyhet, do të aranzhohet një kohë dhe datë e përshtatshme në pajtueshmëri me këtë seksion.

8.7.2 Arsytet për shtyrjen apo anulimin mund të përfshijnë si më poshtë por mund të mos kufizohen vetëm me to:

- a) Moti i keq;
- b) Mungesa e stabilimenteve;
- c) Rreziku serioz i ndërprerjeve të energjisë:

8.7.3 Asnjë **palë** nuk do të ketë të drejtën e shtyrjes apo anulimit të **testimit të sistemit** vetëm për arsye komerciale.

8.7.4 Në rastin kur një **testim i sistemit** është shtyrë, do të aranzhohet një kohë dhe datë tjetër e përshtatshme në përputhje me këtë seksion.

8.7.5 Në të gjitha rastet **testimi i sistemit** do të kryhet sipas programit të miratuar të testimit.

8.7.6 Nëse një **testim i sistemit** i planifikuar si duhet, i aranzhuar dhe i dakorduar si duhet, duhet të anulohet për shkak se njëra nga **palët** dështon në përmbushjen e detyrimeve të saj, atëherë **OST** ose do të aranzhojë një datë alternative për testim ose do t'ia referojë çështjen **Rregullatorit**.

8.8 Raporti final

8.8.1 Në përfundim të **testimit të sistemit**, **OST** së bashku me propozuesin e testimit do të jenë përgjegjës për përgatitjen e raportit me shkrim brenda një muaji nga përfundimi i testimit. Paneli i testimit do ta miratojë këtë raport final të **testimit të sistemit** para se ai t'i paraqitet **OST** për miratimin final.

8.8.2 Ky raport final do të përfshijë një përshkrim të **stabilimentit dhe aparaturave** të testuara dhe testimin e **sistemit** që është krye si dhe rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet.

8.8.3 Sapo të jetë miratuar nga **OST**, raporti final do t'u shpërndahet vetëm **palëve** të ndikuara, **Rregullatorit**, Ministrisë përkatëse për energji dhe çdo **pale** tjetër të përfaqësuar në panelin e testimit.

8.8.4 Kur të jetë dorëzuar raporti final sipas këtij seksioni atëherë paneli i testimit do të shpërndahet.

8.9 Kostot

Në përgjithësi **testimet e sistemit** kryhen në përfitim të të gjitha **palëve** dhe nëse nuk ka arsye thelbësore, të gjitha **palët** e përfshira në ndonjë **testim të sistemit** duhet të mbulojnë kostot e tij, por në çdo rast ato duhet të caktohen me marrëveshje.

(Fundi i dokumentit)